

Muhammed Nasirudin el-Albani

Kënaqësia
bashkëshortore

Kënaqësia bashkëshortore.



Titulli i Librit: “Çfarë keni dashur të dini e që nuk keni mundur të pyesni për jetën martesore në islam”

Autor: Shejkh Muhamed Nasirud-Din el-Albani, (RahimehUllah)

Istanbuli: Vedad Lut

Recensent: Jusuf Hajrullahu

Lektor: Lejla Shala

Përmbajtja:

01 - JETA SEKSUALE:

02 - MARRËDHËNIET INTIME NË KURAN DHE NË SUNNET:

03 - DISPOZITAT LIDHUR ME MARTESËN DHE ME MARRËDHËNIET INTIME:

04 - Bontoni me rastin e natës së parë të martesës:

05 - Vendosja e dorës në kokën e bashkëshortes dhe leximi i duasë:

06 - Falja e namazit të përbashkët të bashkëshortëve:

07 - Çfar duhet të thonë bashkëshortët gjatë marrëdhënieve intime?

08 - Si duhet bashkëshorti t'i afrohet gruas së tij?

09 - Ndalimi i marrëdhënieve seksuale në vrimën anale:

10 - Marrja e avdesit në mes dy marrëdhënieve seksuale:

- 11 - Larja është më e vlefshme:
- 12 - Larja e përbashkët e bashkëshortëve:
- 13 - Marrja e avdesit nga ana e njeriut xhunub para fjetjes:
- 14 - Dispozitat lidhur me këtë avdes:
- 15 - Tejemumi te personi xhunub e zëvendëson avdesin:
- 16 - Larja para gjumit është më e mirë:
- 17 - Ndalimi i marrëdhënieve seksuale me gruan gjatë menstruacioneve:
- 18 - Kefareti për personin që ka marrëdhënie intime me gruan gjatë menstruacioneve:
- 19 - Çka i lejohet njeriut të gruaja në menstruacione?
- 20 - Kur lejohen marrëdhëniet seksuale pasi që gruaja të pastrohet?
- 21 - Lejimi i azlit:
- 22 - Më mirë është të mos bëhet azli:
- 23 - ÇFARË DËSHIROJNË BASHKËSHORTËT ME MARTESË?
- 24 - Çfarë bëhët në mëngjësën e martesës?
- 25 - Shtëpia patjetër duhet të ketë banjo:
- 26 - Ndalimi i përhapjes së fshehtësive martesore:
- 27 - Obligimi i gostis së dasmës:
- 28 - Sunetet e gostisë së dasmës:
- 29 - Lejohet gostia e dasmës edhe pa mish:
- 30 - Pjesëmarrja materiale e të pasurve në gostinë martesore:
- 31 - Ndalohet thirrja në dasmë vetëm e të pasurve:
- 32 - Obligueshmëria që t'i përgjigjemi thirrjes:
- 33 - Duhet t'i përgjigjemi thirrjes, madje edhe nëse jemi agjërueshëm:
- 34 - Prishja e agjërimit me insistim të atij që ka ftuar në gosti:

35 - ATË QË DUHET TA DIJË SECILI BASHKËSHORTË.

36 - A i lejohet burrit që të shikojë në organin gjenital të gruas së tij dhe gruas të shikojë në organin gjenital të burrit të saj?

37 - A është sunnet që bashkëshorti të lozë me gruan dhe ta ledhatojë atë para marrëdhënieve seksuale?

38 - Bashkëshorti a mund të lozë me gruan gjatë agjërimit?

39 - A lejohet thithja e gjuhës dhe buzëve të gruas?

40 - A është e lejuar që burri dhe gruaja të bisedojnë e të flasin gjatë marrëdhënieve seksuale?

41 - A lejohen psherëtimat dhe zëri i lartë gjatë marrëdhënieve seksuale?

42 - Çfarë u lejohet burrit te gruaja me rastin e marrëdhënieve seksuale?

43 - A i lejohet burrit që të kënaqet me pjesën e jashtme të prapanicës, pa marrëdhënie seksuale në vrimën anale?

44 - Cila është dispozita e prekjes dhe puthjes së organit gjenital të bashkëshortëve?

45 - KUR ËSHTË E OBLIGUAR LARJA E BASHKËSHORTËVE?

46 - ÇKA ËSHTË MIRË GRUAJA TË BËJË PARA MARRËDHËNIEVE?

47 - CILAT JANË POZICIONET MË TË MIRA NË MARRËDHËNIET SEKSUALE?

48 - A ekzistojnë pozita të tjera?

49 - Orgazma më shpejt vjen te burri apo te gruaja?

50 - Si ta vendosim balancën seksuale mes burrit e gruas?

51 - Cila është lidhja në mes gjinjve dhe organit gjenital?

52 - A ndikon gjatësia e organit gjenital të burrit në kënaqjen seksuale të gruas?

53 - Si të ruhet dashuria e zjarrtë në martesë?

54 - ZONAT EROGJENE NË TRUPIN E BURRIT DHE GRUAS.

55 - DISA PROBLEME NË JETËN SEKSUALE DHE SHËRIMI I TYRE.

- 56 - Sihri a ndikon në aftësinë seksuale?
- 57 - A ndikon masturbimi në marrëdhëniet seksuale?
- 58 - Puna intelektuale a ndikon në dobësimin e dëshirës seksuale?
- 59 - A ndikon diabeti në aftësinë seksuale?
- 60 - Ejakulimi i burrit para gruas a është shenjë e dobësisë seksuale?
- 61 - Si të ndalohet ejakulimi i parakohshëm?
- 62 - Afrodiziakët që forcojnë dëshirën seksuale:
- 63 - A ekziston lidhja në mes hurmave të thata e të buta dhe seksit?
- 64 - A ekziston lidhja në mes mjaltit dhe aftësisë seksuale?
- 65 - A ekziston lidhja në mes mishit të peshkut dhe aftësisë seksuale?
- 66 - A ekziston lidhja në mes disa llojeve të perimeve dhe aftësisë seksuale?
- 67 - Cila është lidhja në mes disa llojeve të pemëve dhe aftësisë seksuale?
- 68 - Cila është lidhja në mes disa pijeve dhe aftësisë seksuale?
- 69 - Cila është lidhja mes barishteve dhe aftësisë seksuale?
- 70 - Fund.

- **“Ju lajmërojmë se ky libër është kompilacion i disa librave që flasin për këtë temë: (Adabu lejletiz-zefaf) prej shejh Nasiruddin Albani, (Tuhfetularus) prej istanbuliut dhe (Muasheretuz-zevxhije) prej Vedad Lut (Vër. Redakt).”**

JETA SEKSUALE:

Jeta e myslimanit është e bazuar e ndëtuar në principe, themele dhe në baza që duhet t'i praktikojë e t'i pasojë si mysliman, ndërsa para së gjithash si njeri të cilin Allahu i Lartësuar e ka nderuar kur thotë:

“Ne i kemi nderuar bijët e Ademit.” (El Isra, 70)

Në një vend tjetër thuhet: **“Në të vërtetë, Ne e krijuam njeriun në trajtën më të përkryer.”** (Et Tin, 4)

Kjo krijesë e mrekullueshme e Allahut është krijesë të cilës Allahu i dha dinjitet, e dalloi dhe e lartësoi mbi krijesat tjera, e krijoi në formën më të bukur dhe e ngriti në vendin më të lartë. Për këtë shkak thotë: **“Pa dyshim, ata që besojnë dhe punojnë vepra të mira – pikërisht ata janë krijesat më të mira.”** (El Bejine, 7)

Ai, shkalla e të cilit është kështu e lartë te Krijuesi i tij, ai duhet të kujdeset që të udhëheqë e të veprojë sipas programit dhe urdhërit të cilin ja ka shpallur Krijuesi i tij dhe që dëshirat e tij seksuale t'i shfrytëzojë ashtu siç do të jet i kënaqurë Allahu i Lartësuar e jo t'u nënshtrohet shejtanëve xhinë dhe njerëz, të cilët do ta çojnë majtas e djathtas, poashtu nuk duhet ti nënshtrohet erës së amoralitetit i cili do ta bartë e hedhë prej një vendi në një vend tjetër, prej një stacioni në një stacion tjetër, prej humnerës në një humnerë tjetër, prej çmendurisë në një çmenduri tjetër...

Këtë sferë të jetës së njeriut duhet ta sqarojmë më hollësisht dhe duhet të gjejmë zgjidhje adekuate me qëllim që njeriu në këto principe ta vendos jetën dhe ta ndërtojë ardhmërinë e tij. Jo vetëm kjo, mbi këto principe e parime ai ta ndërtojë ardhmërinë e shumë gjeneratave të këtij ummeti i cili ka kaluar nëpër etapa të rënda, ka përballuar sëmundje të ndryshme dhe ka tejkaluar kriza të ndryshme.

I Dërguari i Allahut sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem ka thënë: **“Po ua lë dy gjëra me të cilat nuk do të humbni; Librin e Allahut dhe sunnetin tim.”** (El Mustedrek)

Për këtë njeriu është bujar dhe i denjë, sepse Allahu i Lartësuar e ka bërë kalif në Tokë, e ka bërë që të udhëheqë e të drejtojë në Tokë: **“Unë do të krijoj një mëkëmbës (që do të zbatojë ligjet e Zotit) në tokë.”**

Në këtë libër të vogël, do të flasim për këtë nevojë të njeriut me anë të Kuranit dhe sunnetit të të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem.

MARRËDHËNIET INTIME NË KURAN DHE NË SUNNET:

- Që në fillim dëshirojmë që të flasim për atë që e thotë Allahu i Lartësuar në Librin e Tij lidhur me marrëdhëniet intime mës mashkullit e femrës, rreth asaj që e thotë i Dërguari i Allahut sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem dhe rreth asaj që e kanë thënë dijetarët myslimanë duke i komentuar këto fjalë, me qëllim që ndonjë me dituri të mangët, mos të lajmrohet e të thotë se kjo temë është

#tabu, se kjo është turp dhe se për këtë nuk duhet të flitet. Në anën tjetër, prindërit e kanë për obligim që t'i mësojnë fëmijët e tyre për principet islame lidhur me marrëdhëniet seksuale, me qëllim që fëmijët diturinë e tyre mos ta marrin prej burimeve të prishura dhe prej njerëzve të prishur.

Allahu i Lartësuar thotë: **“Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetsoheni pran tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja, për njerëzitë që mendojnë.”** (Er-Rumë, 21)

Nëse lexojmë suren e Kuranit, El-Bekare, do të hasim ajetin: **“Gratë tuaja janë “ara” për ju, prandaj iu afroni “arave” tuaja si të doni. Por bëni diçka (të mirë) për veten tuaj.”** (El-Bekare, 223)

- Duke folur për tefsirin e këtij ajeti, njëri prej mufesirëve thotë: **“Afrojuni grave tuaja nga cila do anë, para, prapa, duke qenë shtrirë ose nën, duke qenë në këmbë ose në shtrat, duke qenë ulur para ose prapa, por marrëdhënia duhet të kryhet në vaginë. Ky është qëndrimi i të gjithë sahabëve, tabiinëve, dijetarëve dhe imamëve të cilët thonë se marrëdhëniet në vrimën anale janë të ndaluara.”** (Fethul-bejan fi mekasidil-Kuran, Ebu Tajjib el-Fettuhi, Katar.)

- Autorët e pëmbledhjeve të haditheve për mendim prej Xhabirit se kishte thënë se si hebrenjët thonin: **“Njeriu nëse afrohet gruas së tij nga mbrapa, duke kryer marrëdhënie në vaginë dhe ajo mbetet shtatzënë dhe lind fëmijë, ai fëmijë do të jetë i vengër.”** Pas kësaj, si përgjigje ndaj pohimit të tyre, është shpallur ky ajet. (Buhari dhe Muslimi)

Ibn Abbasi tregon: “Omeri radijAllahu ‘anhu kishte shkuar te i Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem dhe kishte thënë: **“O i Dërguari i Allahut, u shkatërrova.” “Çfarë të shkatërroi?”** - kishte pyetur Pejgamberi. Omeri kishte thënë: **“Mbrëmë kam pasur marrëdhënie me gruan nga mbrapa.”** Pejgamberi sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem heshti dhe pastaj u shpall ajeti: **“Gratë tuaja janë “ara” për ju, prandaj iu afroni “arave” tuaja si të doni.”** (El-Bekare, 223)

“Kjo do të thotë, prej përpara dhe mbrapa, por ruajuni prej vrimës anale dhe marrëdhënieve gjatë menstruacioneve.” (Ahmedi, Trimidhiu, ndërsa Nesaiu thotë se hadithi është i mirë.)

Hudhejme b. Sabiti tregon se një njeri kishte shkuar te i Dërguari i Allahut sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem dhe e kishte pyetur për marrëdhëniet intime nga mbrapa dhe i Dërguari i Allahut sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem kishte thënë:

“Nëse mendon t'i afroresh gruas nga mbrapa e të kesh marrëdhënie në vrimën përpara, atëherë kjo është e lejuar, por mbrapa në vrimën anale, kjo nuk është e lejuar. Me të vërtetë Allahu nuk turpërohet nga e vërteta dhe mos kryeni marrëdhënie me grat në vrimat anale.” (Trimidhiu.)

Ndërsa Ibën Abbasi thotë: “I Dërguari i Allahut sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem ka thënë: **“Me të vërtetë, Allahu nuk e shikon njeriun që ka marrëdhënie me gruan në vrimën anale.”** (Ahmedi dhe Bejhekiu)

Ibën kethiri në tefsirin e këtij ajeti thotë: **“Gratë tuaja janë “ara” për ju.” Fjala “ara” tregon vendmjelljen e fëmijës...”** prandaj iu afroni **“arave” tuaja si të doni**”, që do të thotë si të doni: përpara ose mbrapa, por në një vend, siç e vërtetojnë këtë hadhithet.

El-Buhari e përmend thënien e Xhabirit i cili kishte thënë se hebrenjtë kanë thënë **“Nëse marrëdhëniet kryhen nga mbrapa, fëmija lind i vëngër.”**

Atëherë u shpall: **“Gratë tuaja janë “ara” për ju, prandaj iu afroni “arave” tuaja si të doni.”** (Transmetojnë Muslimi dhe Ebu Davudi)

Ibën Ebi Hatimi përmend prej Xhabirit se hebrenjtë u kishin thënë myslimanëve: **“Kush i afrohet gruas së tij nga mbrapa, fëmija do të lind i vëngër”** dhe Allahu kishte shpallur: **“Gratë tuaja janë “ara” për ju, prandaj iu afroni “arave” tuaja si të doni.”**

Ibën Xhurejxhi në një hadith thotë se i Dërguari i Allahut sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem kishte thënë: **“Nga përpara ose nga mbrapa, kjo le të ndodh në organin gjenital!”**

Ekzistojnë edhe shumë hadithe të tjera që japin liri në marrëdhëniet intime, me kusht që ato të kryhen në një vend, pra në vaginë. Po ashtu, ekziston ndalesa e marrëdhënieve intime në vrimën anale.:

- Duke komentuar pjesën e ajetit: **“Por bëni diçka (të mirë) për veten tuaj”**, Ibën Kethiri thotë:

“Kjo do të thotë që para marrëdhënieve të thuhet besmelja, sepse Muslimi përmend prej Ibën Abbasit se i Dërguari i Allahut sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem kishte thënë:

“Kush thotë kur i afrohet gruas së tij: Bismilahi, Allahumme xhenIbënadh-shejtan ve xhenibbish-shejtan mimma rezaktena - Në emrin e Allahut. Allah, na mbroj neve prej shejtanëve dhe mbroje prej shejtanit atë me të cilën na furnizon, dhe prej asaj marrëdhënie lind fëmijë, shejtani aspak nuk do ta dëmtojë.”

Një prej kuptimeve të kësaj pjese të ajetit është edhe ajo që njeriu brenda marrëdhënieve intime t'i përfshijë edhe puthjet, ledhatimet, prekjet e buzëve. Paraloja është diçka që pranohet me sheriat, me mendje dhe kjo është në natyrën e njeriut, madje edhe të kafshëve.

Janë shumë hadithe që flasin për këtë problematikë. Ibën Abbasi transmeton se një grua kishte shkuar te i Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem derisa ai ishte me Ebu Bekrin dhe me Halid b. Zejdin dhe kishte thënë: **“Isha e martuar për Rifai el-Karziun dhe ai më shkurorëzoi dhe pas tij u martova me Abdurrahman b. Zebirin, kurse ai (organin gjenital) e ka sa një njerith.”** Ajo e kapi një pjesë të mantelit të saj duke sjell shembull. Shikojeni këtë pamje para të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem dhe Ebu Bekrit! Gruaja e përshkruan organin e burrit të vet, madje ajo ankohet se ai është i dobët dhe se nuk mund ta kryejë obligimin e tij ndaj gruas. Në natyrën e gruas është që ta urrejë burrin që nuk mundet seksualisht ta kënaqë dhe i cili ka epsh të dobët. Pejgamberi salallahu aleji ue selem në këtë buzëqeshi dhe tha: **“A dëshiron të kthehesh te burri yt i parë? Jo, derisa nuk e përjeton kënaqësinë e tij dhe ai nuk e përjeton kënaqësinë tënde.”** (Hadithin e përmend Buhariu dhe Muslimi).

- Kjo ngjarje tregon se në islam nuk ka tema tabu, por se është e patjetërsushme të bisedohet që i preokupojnë njerëzit.

Buhariu në librin e martesës përmend prej Xhabirit se ai duke u kthyer prej një ekspedite me të Dërguarin e Allahut, kishte thënë se kishte shpejtuar me deven e tij. Dikush ishte pas tij dhe Xhabiri ishte kthyer dhe e kishte parë të Dërguarin e Allahut. Ai e kishte pyetur: **“Pse po shpejton?”** Pejgamberi e pyeti: **“A ke martuar virgjëresh apo vejush?”** Ai i kishte thënë: **“Vejushë.”** Pejgamberi sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem tha: **“Pse nuk ke martuar ndonjë vajzë që të lozësh me të dhe ajo me ty?”**

Muslimi transmeton prej Abdullah b. Amrit se i Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem kishte thënë: **“Dynjaja është kënaqësi, ndërsa kënaqësia më e mirë është gruaja e mirë.”**

Ajo që duhet t'i paraprijë marrëdhënieve seksuale është paraloja, në të cilën burri e përkëdhel gruan, e puthë atë dhe ia thithë gjuhën asaj. **“Ebu Davudi transmeton se i Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem e kishte puthur Aishen dhe e kishte thithur gjuhën e saj.”** (E përmend Ebu Davudi (2386) dhe në kapitullin e agjërimin (234), kurse në zinxhir ka dobësi.)

Janë të shumta qëndrimet e dijetarëve të cilët flasin për marrëdhëniet intime. Ibën Kajimi në Zadul-Mead thotë: **“Kur është në pyetje marrëdhënia seksuale, atëherë udhëzimi i Pejgamberit sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem është i plotë dhe i përsosur në ruajtjen e shëndetit, në arritjen e plotë të knaqësisë, në arritjen e knaqësisë shpirtërore dhe në plotësimin e të gjitha intencave që dëshirohen të arrihen me anë të marrëdhënieve seksuale. Në esencë, ekzistojnë tre qëllime që të arrihen me të:**

- Ruajtja dhe përhapja e llojit njerëzorë;
- Largimi i lëngjeve, grumbullimi i të cilave në trup i bëjnë dëmë njeriut;
- Arritja e knaqësisë dhe kënaqja në begatitë.”

Në librin e imam Ahmedit Ez-Zuhd thuhet se imami kishte thënë: **“Mund të përmbahen prej ushqimit e pijes, por nuk mund të përmbahen prej grave (mendohet në gratë që i ka hallall).”**

Ahnef b. Kajsi kishte hyrë te Muavia b. Ebi Sufjani te i cili ishte djali i tij Jezidi i cili shikonte i mahnitur. Muaviu e pyeti: **“Ebu Bahr, çka mendon për fëmijët?”** Ai u përgjigj: **“O prijës i besimtarëve, ata janë shtylla te të cilët mbështetemi dhe gëzimi i syve tanë. Me anë të tyre i tejkalojmë armiqtë tanë dhe ata janë trashëguesit tanë. Atyre u ka hije shtrati i butë që i mbron prej tokës dhe mjegulla që u bën hije prej diellit. Nëse të kërkoni diçka, jep dhe mos ua ndalo e që pastaj ta urrejnë afërsinë tënde, ta urrejnë jetën tënde dhe ta dëshirojnë vdekjen tënde.”** Muaviu i tha: **“Allahu të shpërbleftë o Ebu Bahr, ata janë pikërisht ashtu siç përshkrove.”**

DISPOZITAT LIDHUR ME MARTESËN DHE ME MARRËDHËNIET INTIME:

- **Bontoni me rastin e natës së parë të martesës:**

Njeriu kur hynë te bashkëshortja e tijm është e pëlqyer që të sillet në mënyrë të mirë me të, si për shembull; t'i ofroj diçka të pijë e të ngjajshme, sepse

transmetohet një hadith se Esmā b. Jezid b. Sekeni kishte thënë: **“Unë e stolisa Aishen për Pejgamberin sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem, shkova te ai dhe e thirra që të shikojë atë të zbuluar, ai u ul afër saj dhe ia ofroi një gotë të madhe me qumësht prej së cilës Pejgamberi sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem piu dhe ia ofroi asaj, mirëpo ajo e uli kokën dhe u turpërua.”** Më tej Esmā thotë: **“Unë e qortova dhe i thashë: ‘Merr prej dorës së të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem’ dhe ajo mori dhe piu pak.”**

Pejgamberi sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem i tha: **“Jepi shoqes tënde.”**

Esmā tha: **“Jo o i Dërguari i Allahut, merre ti dhe pi prej saj dhe ma ofro me dorën tënde.”** Esmā thotë: **“Pastaj u ula dhe e vendosa enën në gjurin tim, pastaj fillova ta lëviz me buzët e mia me qëllim që ta qëlloj vendin prej ku ka pirë i Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem, kurse ai ju tha grave që ishin te unë: “Merrni.” Ato thanë: “Nuk duam.”**

Pejgamberi sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem tha: **“Mos e bashkoni urinë me gënjeshtër.”** (Transmeton Ahmedi (| | /438,452,453,458.)

• **Vendosja e dorës në kokën e bashkëshortes dhe leximi i duasë:**

- Burri duhet ta vendosë dorën e tij në ballin e bashkëshortes kur hynë te ajo ose para se të hyjë, të përmend emrin e Allahut, të lutët për bereqet dhe për bekim dhe ta thotë atë që transmetohet në fjalët e të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem se kishte thënë: **“Kur ndonjëri prej jush martohet ose blen ndonjë shërbëtores, le t’ia vendosë dorën në ballë, le ta përmend emrin e Allahut, le të lutet për bekim duke thënë: “Zoti im, të lutem Ty që prej saj të kem vetëm të mira me të mirën të cilën Ti e ke krijuar, ndërsa kërkoj mbrojtje prej të keqes së saj dhe të keqen e asaj me të cilën Ti e ke krijuar.”** (Pra, të keqen me të cilën ti e ke krijuar dhe e cila është mbjellë te ajo.)

“Kush blenë deve, le ta kapë për majën e gungës dhe le të thotë dua të njëjtë.” (Hadithin e përmend Buhariu në Efalul-ibad në f. 88, Ebu Daudi I/336, Ibën Maxhe I/592, Hakimi II/185, Bejhekiu VII/148.)

• **Falja e namazit të përbashkët të bashkëshortëve:**

- Është mirë që bashkëshortët bashkarisht t'i falin dy rekate, sepse kjo transmetohet prej selefëve të ndershëm. Lidhur me këtë ekzistonë dy thënie.

- E para prej tyre thënia që transmetohet prej Ebu Seidit, tutorit të Ebu Usejdit, se kishte thënë: **“Kam qenë rob kur u martova. E thira një grup të sahabëve të të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem, në mesin e të cilëve ishin Ibën Mes'udi, Ebu Dherri dhe Hudhejfe.”** U ngritëm të falim namaz dhe Ebu Dheri u nis para nesh, kurse ata thanë: **“Na prij në namaz.”** Unë iu priva në namaz, ndërsa unë isha rob. Ata më mësuan dhe më thanë: **“Kur te ti hyn gruaja jote, fali dy rekate, pastaj lute Allahun për të mirën që është te ajo dhe kërko prej Tij mbrojtje prej të keqes që është te ajo, pastaj bën çfar të duash.”** (E përmend Ebu Bekr b. Ebi Shejbe.)

- Thënia e dytë është ajo që përmendet prej Shekikut se kishte thënë: **“Kishte ardhur një njeri me emrin Ebu Harith dhe kishte thënë: “Jam martuar me një robëreshë të re dhe kam frik se do të më urrejë.”** Abdullah b. Mes'udi tha: **“Me të vërtetë afërsia dhe harmonia janë prej Allahut të Lartësuar, kurse ndarja dhe dis'harmonia janë prej shejtanit. Ai dëshiron që ju t'i urreni gjërat të cilat Allahu ua ka lejuar. Për këtë, kur vjen te ti, urdhëroje që me ty t'i falë dy rekate.”** Në rivajetin tjetër transmetohet se Ibën Mes'udi kishte thënë: **“Allahu im, më jep bereqet te gruaja ime dhe asaj te unë. Bëje që takimi dhe jeta jonë të jetë vetëm se mirë, ndërsa nëse na ndanë, na mundëso që edhe në të, të ketë mirësi.”** (E përmend Ebu Bekr b. Shejbe, po ashtu edhe Abdur-Rezaku.)

• Çfar duhet të thonë bashkëshortët gjatë marrëdhënieve intime?

- Burri kur i afrohet gruas së tij, duhet të thotë: **“Allahumme xhenibënash-shejtane ue xhenibbnish-shejtane mimma rezaktena - Allahu im, largoje shejtanin prej nesh dhe largoje shejtanin prej atij që do të niset.”** Pejgamberi sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem ka thënë: **“Nëse Allahu e cakton që t'u lind fëmijë, shejtani kurrë nuk do ta dëmtojë.”** (E përmend Buhariu në Sahihun e tij IX/187.)

• Si duhet bashkëshorti t'i afrohet gruas së tij?

- Burrit i lejohet që të ketë marrëdhënie intime me bashkëshorten nga cilado anë, përpara ose nga mbrapa, por në vaginë, sepse Allahu i Lartësuar thotë: **“Gratë tuaja janë “ara” për ju, prandaj iu afroji “arave” tuaja si të doni.”** (El-Bekare, 223) Kjo do të thotë, si të dëshironi, përpara ose nga mbrapa. Në këtë temë do t'i përmendim dy hadithe.

- Hadithi i parë transmetohet prej Xhabirit radijallahu anhu se kishte thënë: **“Hebrenjët kanë thënë: Kur burri ka marrdhënie me gruan e tij nga mbrapa në vaginë, fëmija që do të mbarset në këtë marrdhënie, do të jetë i vengët.”**

Allahu i Lartësuar e ka shpallur ajetin: **“Gratë tuaja janë “ara” për ju, prandaj iu afroni “arave” tuaja si të doni.”** (El-Bekare, 223)

Pejgamberi sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem ka thënë: **“Nga para ose nga mbrapa, vetëm le të jetë në organin gjental.”** (Hadithin e transmeton Buhariu VIII/154, Muslimi IV/156.)

- Transmetohet prej Ibën Abbasit se kishte thënë: **“Ensarët kanë jetuar me hebrenjët ndërsa kanë qenë idhujtarë, kurse hebrenjtë kanë qenë ithtarë të Librit. Ensarët i kanë konsideruar ata më superior në dituri dhe kanë pasur shumicën e veprimeve të tyre. Kitabijtë u afroreshin grave të tyre vetëm prej anësh dhe ensarët këtë traditë e kishin marrë prej tyre.”**

- Pasi që muhaxhirët erdhën në Medinë, njëri prej muhaxhirëve e kishte martuar një grua ensare. Ai ishte nisur që t'i afrohet asaj, por ajo e kishte refuzuar duke i thënë: **“Burrat tanë u afrohen grave prej anësh, vepron kështu ose largohu prej meje”**, derisa kjo nuk u bë një çështje e madhe serioze e cila depërtoi deri te i Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem dhe Allahu e shpalli ajetin: **“Gratë tuaja janë “ara” për ju, prandaj iu afroni “arave” tuaja si të doni.”** (El-Bekare, 223) Kjo do të thotë përpara, mbrapa, në shpinë, mirëpo në vendin e lindjes së fëmijës."

• **Ndalimi i marrëdhënieve seksuale në vrimën anale:**

Burri e ka të ndaluar që të ketë marrëdhënie seksuale me bashkëshorten e tij në vrimën anale në bazë të kuptimit të ajetit të cituar më parë: **“Gratë tuaja janë “ara” për ju, prandaj iu afroni “arave” tuaja si të doni.”** (El-Bekare, 223)

Njëherësh edhe për shkak të shumë haditheve që të njëjtën e ndalojnë, kurse disa prej tyre i përmendëm. Përveç tyre, ekzistojnë edhe hadithe dhe të tjera:

Transmetohet prej Ummu Seleme radijAllahu ‘anha se kishte thënë: **“Muhaxhirët pasi që ishin vendosur në Medinë, ensarët filluan që të martohen me gratë e tyre. Gratë muhaxhire e kishin praktikë që me rastin e marrëdhënieve seksuale t'i vendosin duart në gjunjë ose në tokë ose të lakohen me fytyrë, derisa gratë ensare këtë nuk e bënë. Një burrë muhaxhir kishte kërkuar prej gruas së tij ensare që të veprojë kështu dhe**

ajo kishte refuzuar derisa nuk e kishte pyetur të Dërguarin e Allahut sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, mirëpo kisha turp që të pyes dhe e pyeta Ummu Selemen.” Atëherë u shpall ajeti: **“Gratë tuaja janë “ara” për ju, prandaj iu afroni “arave” tuaja si të doni.”** (El-Bekare, 223)

Pejgamberi salallahu aleji ue selem tha: **“Por, marrëdhënia seksuale duhet të kryhet në organin gjenital të gruas.”** (E përmend Ahmedi VI/305, 310, 318, Trimidhiu III/75, ai thotë se është sahih.)

Thënien e dytë e transmeton Ibën Abbasi radijAllahu 'anhu duke thënë: “Erdhi Omer b. Hatabi radijAllahu 'anhu te i Dërguari i Allahut sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem dhe i tha: **“O i Dërguari i Allahut, u shkatërrova.”** Pejgamberi sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem e pyeti: **“Çfar të shkatërroi?”** Ai u përgjigj: **“E kam ndërruar pozitën gjatë marrëdhënieve me gruan time.”** Pejgamberi sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem nuk i tha asgjë. Pas kësaj, të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem i zbriti ajeti: **“Gratë tuaja janë “ara” për ju, prandaj iu afroni “arave” tuaja si të doni.”** (El-Bekare, 223)

Pejgamberi sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem iu përgjigj: **“Afroju asaj nga para ose nga mbrapa, por ruaju marrëdhëniet në vrimën anale dhe derisa është në menstruacione.”** (Transmeton Nesaiu në Ashere II/76, Trimidhiu II/162, Ibën Ebi Hatimi I/39, Teberani III/156, Vahidi f. 53 në zixhir të mirë. Trimidhiu thotë se është hasen.)

Thënien e tretë e transmeton Huzejme b. Sabiti radijAllahu 'anhu se një njeri kishte shkuar te i Dërguari i Allahut sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem dhe e kishte pyetur lidhur me situatën kur burri ka marrëdhënie seksuale me gruan në vrimën anale. Pejgamberi sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem iu përgjigj: **“Është e lejuar.”** Njeriu pasi që u kthye që të largohet, Pejgamberi sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem e thirri ose e dërgoi dikë që ta thërrasë dhe iu drejtua: **“Si the? A the në të dyja vrimat? Nëse the se i afrosh gruas nga mbrapa e që marrëdhënia të kryhet në organin gjenital, atëherë kjo është e lejuar, ndërsa nëse ke menduar që burri t'i afrohet gruas nga mbrapa dhe që të ketë marrëdhënie në vrimën anale, atëherë kjo nuk është e lejuar. Me të vërtetë Allahu nuk turpërohet prej të vërtetës, mos kryeni marrëdhënie intime me gratë tuaja në vrimën e tyre anale.”** (Transmetojnë Shafiu, II/260, Bejhekiu, VII/196.)

Hadithi i katërtë thotë: **“Allahu i Lartësuar nuk e shikon atë njeri që ka marrëdhënie intime me gruan e tij në vrimën e saj anale.”** (E përmend Nesaiu në veprën e tij Ashere, II/87-88, Trimidhiu, I/218, Ibënu Hibbani f. 1302.)

“I mallkuar është ai që ka marrëdhënie intime me gruan e tij në vrimën e saj anale.” (E përmend Ibën Adij I/211, duke transmetuar prej Ukbe Ibënu Amirit me zinxhir të mirë.)

“Kush kryen marrëdhënie intime me gruan derisa ajo është në menstruacione ose në vrimën e saj anale ose shkon te falltori dhe beson në atë që ai thotë, ai është bërë jobesimtarë në atë që i është shpallur Muhamedit sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem.” (E përmendin katër autorët e Suneneve.)

• **Marrja e avdesit në mes dy marrëdhënieve seksuale:**

Burri kur ka marrëdhënie seksuale me gruan e tij, pastaj dëshiron që të njëjtën ta përsërisë, ai duhet të marrë avdes, sepse i Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem thotë:

“Ai që ka marrëdhënie seksuale me gruan e tij, pastaj dëshiron që të njëjtën ta përsërisë, le të marr avdes (pra, ndërmjet dy marrëdhënieve seksuale le të marrë avdes.)” Në një rivajet tjetër transmetohet se ka thënë: **“Le të marrë avdes sikur për namaz, sepse kjo e shton aktivitetin.”** (E përmend Muslimi, I/171.)

• **Larja është më e vlefshme:**

Mirëpo larja është më e vlefshme sesa marrja e avdesit për shkak të hadithit që e transmeton Ebu Rafi' se i Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem një ditë i kishte vizituar gratë e tij, duke u larë te secila. Unë i thash: **“O i Dërguari i Allahut, pse gjithë këtë nuke përfundove me një larje?”** Ai u përgjigj: **“Kështu është më pastër, më përshtatshëm dhe më mirë.”** (E transmeton Ebu Davudi.)

• **Larja e përbashkët e bashkëshortëve:**

Bashkëshortët e kanë të lejuar që bashkë të lahen në një vend, edhe nëse burri shikon në gruan e tij dhe gruaja në burrin e saj. Lidhur me këtë ekzistojnë hadithe që e vërtetojnë këtë.

Argumenti i parë është ai të cilin e transmeton Aisha radijAllahu ‘anha: **“Unë jamë larë bashkë me të Dërguarin e Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem prej një ene, ashtu që të na përziheshin duart, ai merrte më shumë ujë sa që fillova t'i them: “Më lër mua, më lër mua.”** Aisha thotë: **“Ndërsa të dytë ishim xhunub.”** (Transmeton Buhariu, Muslimi dhe Ebu Avane. Albani thotë: **“Kjo është dëshmi për pasaktësinë e asaj që transmetohet prej**

Aishes radijAllahu ‘anha se kishte thënë “Kurrë nuk e kam parë vendin e turpshëm të të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem”)

Transmetohet prej Muavija b. Hajdit se kishte thënë: **“O i Dërguari i Allahut, kur janë në pyetje vendet tona të turpit, çka është e lejuar e çka nuk është e lejuar?”** Pejgamberi sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem tha: **“Ruaje vendin tënd të turpit përveç bashkëshortes tënde dhe prej asaj që është nën pushtetin tënd.”** (Ibën Urve el-Hanbeli në veprën e tij El-Kevakib thotë: **“Secili bashkëshortë e ka të lejuar të shikojë dhe ta prek tërë trupin e bashkëshort (es) it, madje edhe organin gjenital për shkak të këtij hadithi, sepse bashkëshorti e ka të lejuar që të knaqet duke shikuar dhe duke prekur organin gjenital të bashkëshort (es) it të vet. Kjo i lejohet ngjashëm siç lejohet që të shikojë dhe t'i prekë pjesët tjera të trupit.”**)

Ky është mendimi i Malikut dhe i të tjerëve, ndërsa e transmeton Ibënu Sadi prej Vakidit se kishte thënë: **“E kam par Malik b. Enesin dhe Ibënu Ebi Zi'bin se nuk kanë konsideruar si diçka të keqe që njeriu ta shikojë organin gjenital të gruas dhe që gruaja ta shikojë organin gjenital të burrit.”**)

• Marrja e avdesit nga ana e njeriut xhunub para fjetjes:

Personi që është xhunub, nuk duhet të flejë pa avdes. Lidhur me këtë çështje ekzistojnë hadithe të të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem.

Hadithi i parë transmetohet prej Aishes radijAllahu ‘anha se kishte thënë: **“I Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem kur dëshironte të flejë ose të hajë gjersa ishte xhunub, ai e lante vendin e tij të turpshëm dhe mernte avdes sikur për namaz.”** (E përmend Buhariu, Muslimi dhe Ebu Avane në Sahihet e tyre.)

Hadithi tjetër transmetohet prej Ibën Omerit se Omeri radijAllahu ‘anhu kishte thënë: **“O i Dërguari i Allahut, a mundemi të flemë gjersa jemi xhunubë?”** I Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem u përgjigj: **“Mundet pasi që të marr avdes.”** Ndërsa në një rivajet tjetër thuhet se kishte thënë: **“Po, merr avdes, pastaj flen derisa të mos pastrohet atëherë kur të dëshirojë.”** Kurse në rivajetin tjetër thuhet: **“Po, mund të flejë, ndërsa nëse dëshiron, mund të marrë avdes.”** (Këtë hadith e përmendin tre veta në Sahihet e tyre dhe Ibënu Asakiri, II/223)

Hadithin e tretë e transmeton Ammar b. Jasiri se i Dërguari Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem kishte thënë: **“Meleku nuk do t'u afrohet tre njerëzve:**

kufomës së vdekur të jobesimtarit, personit që së tepërmi është lyer me erë (Kjo aromë është prej shafranit dhe prej llojeve tjera të aromave. Ky është i ndaluar për shkak se kjo aromë është e grave.) dhe personit xhunub derisa të mos marrë avdes.” (Hadithi është hasen, e përmend Ebu Davudi në Sunenin e tij II/192-193 me dy zinxhirë.)

• **Dispozitat lidhur me këtë avdes:**

Ky avdes nuk është vaxhib - i obligueshëm. Ai është mustehab i fortë për shkak të hadithit që transmetohet prej Omerit se e kishte pyetur të Dërguarin e Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem se a mund të flejë njeriu që është xhunub. I Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem i kishte thënë: **“Po, nëse do mund të marrë avdes.”** (E transmeton Ibën Hibbani në Sahihun e tij.)

Këtë e vërteton edhe hadithi i Aishes radijAllahu ‘anha e cila kishte thënë: **“Pejgamberi sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem flinte, ndërsa me këtë rast ai as që e kishte prekur ujin. (Derisa nuk zgjohej e nuk lahej).”** (E transmeton Ibën Ebi Shejbe I/45.)

Në një rivajet tjetër thuhet se kishte thënë: **“I Dërguari Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem flinte duke qenë xhunub, vinte Bilalli dhe thërriste për namazin e sabahut. Pejgamberi sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem ngrihej dhe lahej. E kam parë se si i pikonte uji nga koka. Pastaj ai dilte dhe unë e ndëgjoja zërin e tij në namazin e sabahut, ditën e kalonte duke agjëruar.”** Transmetuesi ka thënë: **“I thashë Amirit: ‘Në Ramazan?’** Ai u përgjigj: **“Po, në Ramazan ose jashtë tij.”** (Transmetojnë Ibën Ebi Shejbe, II/183 prej Mesrukut.)

• **Tejemumi te personi xhunub e zëvendëson avdesin:**

Bashkëshortëve u lejohet që në disa situata, në vend të avdesit të marrin tejmum për shkak të hadithit në të cilin Aisha radijAllahu ‘anha thotë: **“I Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem kur ishte xhunub, ndërsa dëshironte të flejë, ai merrte avdes ose tejmum.”** (Transmeton Bejhekiu, I/200)

• **Larja para gjumit është më e mirë:**

Larja e bashkëshortëve para gjumit është më e mirë për shkak të hadithit të cilin e transmeton Abdullah b. Kajsi, në të cilin thuhet: “E pyeta Aishen radijAllahu ‘anha: **“Çfarë bënte i Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem kur ishte xhunub? A pastrohej fillimisht ose më parë flinte e pastaj**

lahej?” Ajo u përgjigj: **“Ai i vepronte të dyja, nganjëherë më parë lahej e flinte, ndërsa nganjëherë merrte avdes dhe flinte.”** Unë i thash: **“Falënderimi i takon Allahut që në këtë gjë ka dhënë fleksibilitet.”** (Transmetojnë Muslimi, I/181, Ebu Avanem I/278 dhe Ahmedi, VI/149 dhe 73.)

• Ndalimi i marrëdhënieve seksuale me gruan gjatë menstruacioneve:

Buri e ka të ndaluar që të ketë marrëdhënie seksuale me bashkëshorten derisa ajo është në menstruacione, për shkak të ajetit në të cilin Allahu i Lartësuar thotë: **“Të pyesin ty (Muhamed) për të përmuajshmet e femrave. Thuaju: “Ajo është gjendje e dëmshme.” Prandaj, gjatë kësaj kohe, mos iu afroni atyre (për marrëdhënie) derisa të pastrohen. Pasi të pastrohen, atëherë afrohuni tek ato ashtu si ju ka urdhëruar Allahu. Pa dyshim, Allahu i do ata që pendohen fort (për gjynahet) dhe ata që pastrohen.”** (EL-Bekare, 222)

Lidhur me këtë temë, ekzistojnë edhe hadithe të të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem.

Në hadithin e parë thuhet: **“Kush kryen marrëdhënie intime me gruan derisa ajo është në menstruacione ose në vrimën anale apo shkon te falltori dhe i beson se çfarë ai thotë, ai e ka mohuar atë që i është shpallur Muhamedit sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem.”** (Hadithi është sahih. Transmetojnë autorët e Suneneve, ashtu siç e tham këtë në kapitujt e mëparshëm.)

Në hadithin e dytë transmetohet prej Enesit radijAllahu ‘anhu se kishte thënë: **“Hebrenjët gratë e tyre, deri sa ishin me menstruacione, i largonin prej shtëpive, nuk hanin e as nuk pinin me to e as që përziheshin me to nëpër shtëpi.”** Pejgamberi sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem ishte pyetur lidhur me këtë dhe i ishte shpallur ajeti: **“Të pyesin ty (Muhamed) për të përmuajshmet e femrave. Thuaju: “Ajo është gjendje e dëmshme.” Prandaj, gjatë kësaj kohe, mos iu afroni atyre (për marrëdhënie) derisa të pastrohen.”** (EL-Bekare, 222)

Dhe Pejgamberi sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem kishte thënë: **“Përzihuni me to dhe punoni të gjitha gjërat me to përveç marrëdhënieve seksuale.”** Pas kësaj, hebrenjët kishin thënë: **“Çfarë dëshiron ky njeri, nuk gjendet gjë në fenë tonë të cilën ai nuk e kundërshton.”**

Usejd b. Hudajri dhe Ubade b. Bishri kishin shkuar te i Dërguari i Allahut sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem dhe i kishte thënë: **“O i Dërguari i Allahut, hebrenjët po thonë kështu, vallë ne nuk bëjmë marrëdhënie me gratë tona gjatë menstruacioneve.”** Fytyra e të Dërguarit të Allahut u ndryshua, ashtu që ne menduam se u zemërua mbi këta dy persona. Ata dolën, por ata i priti dhurata e Pejgamberit në qumësht. Ai e dërogi dikë pas tyre dhe ju dha të pinë. Atëherë menduan se ai nuk ishte zemëruar me ta.” (E përmend Muslimi dhe Ebu Avene në Sahihet e tyre. Po ashtu edhe Ebu Davudi, ndërsa këto janë fjalët e tij.)

• **Kefareti për personin që ka marrëdhënie intime me gruan gjatë menstruacioneve:**

Atë njeri që e pushtojnë epshtet dhe kryen marrëdhënie intime me gruan e tij para se ajo të pastrohet prej menstruacioneve, ai duhet të japë sadaka në një lartësi prej gjysëm funte angleze të aritë ose një të katërtën e saj për shkak të hadithit të cilin e transmeton Abdullah b. Abbasi prej Pejgamberit sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem i cili lidhur me këtë kishte thënë: **“Jep një dinar ose gjysëm dinari.”** (E Përmendin autorët e Suneneve, Teberani në **“Mu-xhumul-kebir”**, Ibënul Arabi në Mu'xhemu, Deramiu, Hakimi, Bejhekiu me zinxhir sahih sipas kushteve të Buhariut. Vlera e një dinarit të aritë është një çerekut osmanlij që peshon 1.80 gr. (vër. recens.)

• **Çka i lejohet njeriut te gruaja në menstruacione?**

Burrit i lehohet që të kënaqet me tërë trupin e gruas përveç organit gjenital. Lidhur me këtë ekzistojnë hadithe të të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem.

I Dërguari i Allahut sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem ka thënë: **“Burri le të bëjë çfarë të dojë, me përjashtim të marrëdhënieve seksuale.”** (Hadithi është pjesë e një hadithi më të gjerë të cilin e transmeton Enesi.)

Në hadithin tjetër transmetohet se Aisha radijAllahu 'anha kishte thënë: **“Pejgamberi sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem disave prej nesh, derisa ishim me menstruacione, na urdhëronte që të shtrëngoheshim në bel, pastaj shtrihej me të.”** Me një rast edhe kishte thënë: **“Dhe prekte trupin e saj.”** (Transmetohet se Sahba' bintu Kerimi kishte thënë: **“I thash Aishes: “Burri çfarë ka të drejtë te gruaja e tij derisa ajo është në hajz?”** Ajo tha: **“Gjithçka, përveç marrëdhënieve seksuale.”** (Këtë hadith e transmeton Ibënu Sadi. Transmetohet prej Aishes radijAllahu 'anha një hadith i ngjashëm

që fletë për agjëruesin, kurse ne e kemi shpjeguar në veprën **“El-ehadithu-sahiha.”**)

Hadithi i tretë transmetohet prej disa grave të Pejgamberit sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem se kishin thënë: **“I Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem kur dëshironte diçka prej gruas së tij derisa ajo ishte me menstruacione, ai e mbulonte vendin e saj të turpit me rroba e pastaj bënte atë që dëshironte.”** (E përmend Ebu Davudi dhe ky është versioni i tij.)

• **Kur lejohen marrëdhëniet seksuale pasi që gruaja të pastrohet?**

“Gruaja pasi që të pastrohet prej menstruacioneve dhe kur ndërpritet rrjedhja e gjakut prej organit të saj gjenital, atëherë pasi që ta pastrojë vendin në të cilën është paraqitur gjaku, merr avdes ose lahet, atëherë lejohen marrëdhëniet seksuale. Çfarë do që të veprojë prej kësaj, burrit i lejohen marrëdhëniet seksuale me të.” (Ky është medhhebi i Ibën Hazmit)

Argument për këtë janë fjalët e Allahut të Lartësuar: **“Pasi të pastrohen, atëherë afrohuni tek ato ashtu si ju ka urdhëruar Allahu. Pa dyshim, Allahu i do ata që pendohen fort (për gjynahet) dhe ata që pastrohen.”** (EL-Bekare, 222)

• **Lejimi i azlit:**

Burrit i lejohet që të eakulojë jashtë vaginës së gruas. Lidhur me këtë ekzistojnë hadithe të të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem.

Në hadithin e parë transmetohet se Xhabiri radijAllahu ‘anhu kishte thënë: **“Ne e bënim azlin në kohën derisa Kurani shpallej.”** Ndërsa në rivajetin tjetër thuhet: **“Ne e bënim azlin në kohën e të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem, ai dëgjoji për këtë, ndërsa ai nuk na e ndaloi.”** (E transmetojnë Buhariu, IX/251, Muslimi, IV/165. Rivajeti i dytë është i Muslimit.)

Transmetohet prej Ebu Seid el-Hudrit se një njeri kishte shkuar te i Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem dhe i kishte thënë: **“O i Dërguari i Allahut, unë e kam një robëreshë me të cilën me rastin e marrëdhënieve seksuale e përdori azlin, duke dëshiruar prej saj atë që e duan meshkujt, kurse hebrenjët po thonë se kjo është vrasje e vogël.”** I Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem tha: **“Hebrenjët kanë gënjyer, sepse sikur të dëshironte Allahu që ta krijojë, ti nuk do të ishe në gjendje që ta**

ndalosh.” (Transmeton Nesaiu në veprën El-Ashere, Ebu Davudi I/237, Tahaviu, II/371, Trimidhiu, II/193 dhe Ahmedi III/33, 51, 53 me zinxhir sahih.)

Transmetohet prej Xhabirit radijAllahu ‘anhu se një njeri kishte shkuar te i Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem dhe i kishte thënë: **“Unë kam një robëreshë që na shërben. Unë kam marrëdhënie intime me të, por nuk dua që të mbetet shtatzënë.”** Pejgamberi sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem i tha: **“Nëse do bënë azlin, por do të ndodhë ashtu siç e ka caktuar Allahu.”** Njeriu pas kësaj erdhi dhe tha: **“Robëresha mbeti shtatzënë.”** I Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem i tha: **“Unë ju lajmërova se do të ndodhë ashtu siç e ka caktuar Allahu.”** (E përmend Muslimi, IV/160, Ebu Davudi, I/339, Bejhekiu VIII/229, Ahmedi, III/312, 386.)

• **Më mirë është të mos bëhet azli:**

Mos kryerja e azlit është më e vlefshme për shkak të këtyre gjërave:

E para: Në azël është dëmi për gruan, sepse ajo nuk kënaqet plotësisht. Nëse edhe gruaja pajtohet me azlin, atëherë dëmi është si vijon: Humbin disa qëllime të martesës, pra numri i ummetit të të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-leme për shkak të hadithit në të cilin ai thotë:

“Martohuni me vajza të reja dhe me ato që lindin, sepse vërtet unë do të krenohem me numrin tuaj para popujve tjerë.” (Hadithi është sahih, transmetojnë Ebu Davudi, I/320, Nesaiu, II/81.)

Për këtë shkak, i Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem kur ishte pyetur për azlin, ai e kishte përshkruar këtë dukuri si vrasje të fshehtë:

“Ajo është vrasje e fshehtë.” (E përmend Muslimi)

Për këtë shkak, Pejgamberi sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem ka treguar në prioritetin e lënies së azlit në hadithin të cilin e transmeton Ebu Seid el-Hudriu radijAllahu ‘anhu në të cilin thuhet: **“Me një rast te i Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem u përmend azli dhe ai tha: “Pse ndonjëri prej jush e bën azlin?”**

Nuk kishte thënë: **“Asnjëri prej jush mos ta bëjë azlin.”**

“Shpirti nuk mund të krijohet e Allahu mos të jetë Krijues i tij.”

Në një rivajet tjetër thuhet: **“Ju me siguri këtë e bëni, ju me siguri këtë e bëni, nuk ka shpirt të cilit nuk i është caktuar që të jetojë deri në ditën e**

kiametit e që nuk ka jetuar.” (Hadithin e përmend Muslimi, IV/158 dhe 159 me dy rivajete.)

ÇFARË DËSHIROJNË BASHKËSHORTËT ME MARTESË?

Bashkëshortët me martesën e tyre duhet të synojnë dëlirësinë dhe rehatinë e shpirtit si dhe shpëtimin prej marrëdhënieve seksuale të cilat i ka ndaluar Allahu i Lartësuar. Allahu i Lartësuar për marrëdhëniet seksuale të bashkëshortëve ka caktuar shpërblimin si dhe ndarjen e sadakasë.

Në këtë tregon hadithi të cilin e transmeton Ebu Dherri radijAllahu ‘anhu në të cilin thuhet: “Disa njerëz kishin shkuar te i Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem dhe kishin thënë: “O i Dërguari i Allahut, na tejkaluani pasanikët, ata falen sikurse ne, agjërojnë sikurse ne, por duke falënderuar pasurisë së tyre, ata japin edhe sadaka.”

I Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem tha: **“Allahu a nuk ua ka dhënë edhe juve atë me të cilën do të ndani sadaka? Me të vërtetë, në secilin tekbir ka sadaka, në secilën thënie të fjalëve: La ilahe il-lAllah ka sadaka, në secilin falenderim të Allahut ka sadaka, në çdo urdhërim në të mirë ka sadaka, në çdo ndalim të të keqes ka sadaka, në marrëdhënie intime të ndonjerit prej jush me gruan e vet ka sadaka.”** Sahabët thanë: **“O i Dërguari i Allahut, vallë në zbrazjen e epsheve të ndonjerit prej nesh ka sadaka?”** Ai u përgjigj: **“Çka mendoni, a ka mëkat nëse këtë e bëni në mënyrë të ndaluar?”** Sahabët iu përgjigjën: **“Gjithsesi se po o i Dërguari i Allahut.”** Ai iu përgjigj: **“Pra sipas kësaj, nëse këtë e bën në mënyrë hallall, ai ka shpërblim.”** (Transmetojnë Muslimi, III/82 dhe ky është versioni i tij, Nesaiu, II/1178, Ahmedi, V/167,168,178.)

• Çfarë bëhet në mëngjesin e martesës?

Është mirë që njeriu në mëngjesin e martesës të shkoj te të afërmit e tij të cilët kanë ardhur në shtëpinë e tij, t'i përhëndes me selam dhe ta lutë Allahun për ta, kurse edhe ata ta përhëndesin, sepse transmetohet prej Enesit radijAllahu ‘anhu se kishte thënë: **“Pejgamberi sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem kishte përgaditur gosti kur ishte martuar me Zejneben, ashtu që muslimanët ishin ngopur me bukë e me mish. Pastaj i Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem kishte shkuar te nënat e besimtarëve, i kishte përshëndetur dhe e kishte lutur Allahun për to, por edhe ato e kishin**

përschëndetur dhe ishin lutur për të. Kjo kishte ndodhur në mëngjesin e martesës.” (Transmetojnë Ibën Sa'di, VIII/108 dhe Nesaiu në veprën El- Velime, II/66 me zinxhir sahih.)

• **Shtëpia patjetër duhet të ketë banjo:**

Bashkëshortët e kanë për obligim që në shtëpi të posedojnë vend të caktuar për t'u larë. Ata e kanë të ndaluar që të shkojnë në banjën e qytetit, sepse vërtetë kjo është haram dhe për këtë ekzistojnë hadithe të të Dërguarit të Allahut sal- lAllahu 'alejhi ue sel-lem.

Transmetohet prej Xhabirit radijAllahu 'anhu se kishte thënë: **“I Dërguari i Allahut sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem ka thënë: “Kush beson në Allahun dhe në ditën e gjykimit, gruaja e tij të mos të hyjë në hamam, kush beson në Allahun dhe në ditën e gjykimit, mos të hyjë në hamam përveç duke qenë i mbështjellë, kush beson në Allahun dhe në ditën e gjykimit, mos të ulet në atë tavolinë ku konsumohet alkoholi.”** (E përmend Hakimi, IV/288, Trimidhi, Nesaiu, Ahmedi, III/339.)

Transmetohet prej Ummi Derda se kishte thënë: **“Dola prej hamamit dhe më takoi i Dërguari i Allahut sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem dhe më tha: “Prej ku po vjen Ummu Derda?”** Iu përgjigja: **“Prej hamamit.”** Ndërsa ai tha: **“Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, nuk ka grua e cila i hjek rrobet e saj në ndonjë vend tjetër përveçse në shtëpinë e nënës së vet e të mos coptohet perdja që gjendet në mes saj dhe Mëshiruesit.”** (E përmend Ahmedi dhe Davlabi, me dy zinxhirë.)

Transmetohet prej Ebu Muhejlit se kishte thënë: **“Kishin hyrë gratë prej Shami te Aisha radijAllahu 'anha dhe ajo i kishte pyetur: “Prej nga po vini?”** Ato ishin përgjigjur: **“Prej Shamit.”** Aisha i tha atyre: **“Ndoshta ndonjëra prej jush viziton hamamim?”** Ato u përgjigjën: **“Po.”** Aisha radijAllahu 'anha tha: **“Me të vërtetë unë e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem duke thënë: “Nuk ka grua e cila i hjek rrobet e saj në ndonjë vend tjetër përveçse në shtëpinë e vet e të mos coptohet perdja që gjendet në mes saj dhe Allahut të Lartësuar.”** (E përmendin autorët e Suneneve, përveç Nesaiut.)

• **Ndalimi i përhapjes së fshehtësive martesore:**

Secili prej bashkëshortëve e ka të ndaluar që t'i tregojë fshehtësitë lidhur me jetën e tyre seksuale.

I Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem thotë: **“Me të vërtetë në pozitën më të keqe te Allahu në ditën e gjykimit do të jenë njerëzit që kanë marrdhënie intime me gratë e tyre dhe gratë që kanë marrdhënie me burrat e tyre, pastaj të njëjtit i tregojnë fshehtësitë e tyre.”**

(Transmetojnë Ibën Ebi Shejbe, VIII/67, Muslimi IV/157, Ahmedi, III/69, Ebu Ne’imi, Ibën Senijj, Bejhekiu, VII/193-194 prej Ebu Seid el-Hudriut.)

Transmetohet prej Esma b. Jezidit se kishgte qenë te i Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem, derisa te ai ishin gra e burra dhe ai tha: **“Ndoshta në mesin tuaj ka burra të cilët e tregojnë atë që e bëjnë me gratë e tyre, por ndoshta ka edhe gra që tregojnë atë që e bëjnë me burrat e tyre.”**

- Njerëzit heshtën, ndërsa unë thashë: **“Po për Allahun, o i Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem gratë e bëjnë këtë, por të njëjtën e bëjnë edhe burrat.”**

- Ai tha: **“Mos e bëni këtë, sepse vërtetë ai që e bënë këtë, ai është i ngjajshëm me shejtanin i cili rrugës e takon shejtanin femër dhe me të kryen marrdhënie, kurse njerëzitë tjerë këtë e shikojnë.”** (E përmend Ahmedi)

• **Obligimi i gostis së dasmës:**

Është e domosdoshme që të përgaditet solemniteti i martesës, sepse i Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem e kishte urdhëruar Abdurrahman b. Aufin që të përgadisë gostinë e martesës, por edhe për shkak të hadithit të cilin e transmeton Burejde b. Husejbi ku thuhet: **“Aliu pasi që e kishte kërkuar dorën e Fatimës radijAllahu ‘anha, Pejgamberi sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem tha: “Patjetër që dhëndërrit të përgadisë gostinë e dasmës.”** (Transmeton Ahmedi, V/359, Taberani, I/112, Tahaviu, IV/144-145, Ibënu Asakiri).

Më tej thotë: **“Sa'di tha: “Unë e kam një dash.” Tjetri tha: “Unë kam bajagi misër.”** Në një rivajet tjetër, thuhet: **“Një grup i ensarëve i mblodhën një sasi të misrit.”**

• **Sunetet e gostisë së dasmës:**

Patjetër të kemi vëmendjen në këto gjëra:

Dasma duhet të zgjasë tre ditë, sepse kjo transmetohet prej Pejgamberit sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem. Transmetohet prej Enesit radijAllahu ‘anhu se kishte thënë: **“Pejgamberi sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem ishte martuar me njëren**

prej grave të tij dhe më dërgoi e unë i thirra njerëzit për ushqim.”

(Transmeton Buhariu IX/189, 194 Bejhekiu, VII/260).

Prej tij po ashtu transmetohet: **“Pejgamberi sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem u martua me Safijën, liria e saj ishte dhurata e martesës dhe përgaditi gostinë e martesës e cila zgjati tri ditë.”** (E përmend Ebu Ja'la me zinxhirin hasen).

E dyta: Që në gosti t'i thërrasë robërit e mirë e të devotshëm, qofshin ata të varfër ose të pasur, sepse i Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem thotë: **“Shoqërohu vetëm me besimtarin dhe ushqimin tënd le ta hajë vetëm ai që është i devotshëm.”** (Transmetojnë Ebu Davudi, Tirmidhiu, Hakimi, IV/387 dhe Ahmedi prej Ebu Seid el-Hudriut. Hakimi thotë: **“Zinxhiri i tij është sahih.”**)

E treta: Të bëjë gosti duke therë një dele ose më shumë, sepse transmetohet prej Enesit radijAllahu ‘anhu se kishte thënë: **“Abdurrahman b. Aufi erdhi në Medinë dhe i Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem e vëllazëroi me Sa'di b. Rebia. Sa'di e mori në shtëpinë e tij. Kishin kërkuar ushqim dhe kishin ngrënë. Pas ngrënies, Sa'di iu drejtua: “Vëlla, unë jam njëri prej njerëzve më të pasur në Medinë”, në një rivajet tjetër thuhet: “Unë jam ensari më i pasur.” “Shiko në gjysmën e pasurisë time dhe merre atë.”**

(Në rivajet tjetër thuhet: **“Eja në kopshtin tim dhe unë do ta jap gjysmën e saj. Unë i kam dy gra (kurse ti je vëllai im në fe dhe nuk je i martuar), shiko se cila prej këtyre djave po të pëlqen më shumë, unë do ta shkurorëzoj (dhe kur t'i kaloj iddeti) ti martoje atë.”** Abdurrahmani tha: **“(Jo për Allahun) Allahu të begoftë në familje dhe pasuri, ma trego tregun.”** Ai e dërgoi në treg, ai shkoi atje, bleu dhe shiti dhe kështu përfitoi. U kthye me pak djathë dhe tëlyen dhe me këto gjëra shkoi te familja e tij. Kaloi aq kohë sa deshti Allahu që të kaloj dhe ai u kthye, ndërsa në të kishte gjurmë të shafranit (në një rivajet tjetër: **“një lloj parfumi prej shafrani (bëhet fjalë për aromën që e përdor dhëndrri), i Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem tha: “Çka është kjo?”** Abdurrahmani u përgjigj: **“O i Dërguari i Allahut, jam martuar (me ensare).”**

Pejgamberi sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem e pyeti: **“Sa ishte mehri yt?”**

Ai u përgjigj: **“Pesë dërrhemë.”** I Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem i tha: **“(Allahu të bëkoftë) Bëre një gosti, edhe nëse e therë një dele (dhe ia lejoj këtë).”**

Abdurrahmani thotë: **“Sikur të më shihje sikur të ngrihja një gur prej toke, do të prisja që nën të të gjejë ari ose argjend.”**

Enesi thotë: **“Kam parë pjesët që i trashëguan gratë e tij pas vdekjes së tij, secilapjesë arrinte njëqind mijë dinarë.”** (Transmeton Buhariu, IV/232, VII/89, IX, 95 dhe 190-192, Nesaiu,II/93, Ibënu Sa'di, III/77, Bejhekiu, VII/258, Ahmedi, III/165, 190, 204, 226, 271).

Transmetohet prej Enesit radijAllahu ‘anhu se kishte thënë: **“Nuk kam parë që i Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem e ka bërë gostinë sikur kur ishte martuar me Zejneben. Ai e theri një dele (njerëzit kanë ngrënë bukë dhe mish derisa nuk u ndalën vetë).”** (Transmeton Buhariu, VII/192, Muslimi, IV/149, shtojca është në versionin e tij. Ebu Davudi, II/137, Ibënu Maxhe, I/59, Ahmedi, III/98, 99, 105, 163, 172, 195).

• **Lejohet gostia e dasmës edhe pa mish:**

Lejohet që të bëjnë gosti dasme me çfardo ushqimi, edhe nëse në të nuk ka mish, sepse transmetohet se Enesi radijAllahu ‘anhu kishte thënë:

“Pejgamberi sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem kishte qëndruar tri netë mes Hajberit dhe Medinës kur ishte martuar me Safijën. Ai i kishte ftuar muslimanët në gostinë e dasmës, ndërsa nuk kishte as bukë as mish. Kishte urdhëruar që në rërë të shtrijnë hasrat e lëkurës dhe të njëjtat i shtrinë (në rivajet tjetër thuhet se e kishin bërë një gropë në rërë dhe njerëzitë kishin sjellë dhe këtu i kishin vendosur ato që i kishin.) Disa kishin sjellë hurma, disa djathë, disa tëlyen (dhe kështu njerëzitë ishin ngopur).” (Transmeton Buhariu, VIII/387)

• **Pjesëmarrja materiale e të pasurve në gostinë martesore:**

Ata që posedojnë mjete dhe pasuri është mirë të marrin pjesë në përgaditjen e gostisë së dasmës, sepse transmetohet se Enesi radijAllahu ‘anhu në tregimin rreth martesës së Pejgamberit sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem me Safijën, kishte thënë:

“Për rrugëtim, Safijën e kishte përgaditur Ummu Sulejma dhe ajo ia kishte dorëzuar të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem natën, kështu që ai kishte gdhirë si dhëndër.” Ai kishte thënë: **“Kush ka prej jush diçka, le të sjellë (në rivajetin tjetër: “Kush ka disa furnizime të vlefshme, le të na i sjellë).”**

Enesi vashdon: **“Pejgamberi sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem e shtriu hasrën e lëkurës dhe njerëzitë vinin duke sjellë djathë, hurma dhe tëlyen dhe prej tyre përgaditën ushqim dhe pinë shiun e grumbulluar në basen). Kjo ishte gostia e dasmës e të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem.”** (E përmend Buhariu dhe Muslimi, Ahmedi, III/102, 159. Ai trasmeton rivajet tjetër. Ibënu Sa'di, VIII/122-123, Bejhekiu, VII/259, ky citat është i tij, ndërsa në citatin e Muslimit është shtojca, IV/148.)

• **Ndalohet thirrja në dasmë vetëm e të pasurve:**

Nuk lejohet që në gostinë e martesës të preferohen vetëm të pasurit, duke i injoruar të varfërit, sepse i Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem ka thënë:

“Gostia më e keqe është ajo gosti në të cilën thirren vetëm të pasurit, kurse injorohen të varfërit. Ajo që nuk i përgjigjet thirrjes, ai ka bërë mekat ndaj Allahut dhe ndaj Pejgamberit të Tij.” (Transmetojnë Muslimi, IV/154 dhe Bejhekiu, VII/262 prej Ebu Hurejres.)

• **Obligueshmëria që t'i përgjigjemi thirrjes:**

Secili që thirret në gostinë e martesës, ai e ka për obligim që t'i përgjigjet thirrjes dhe të prezentojë, sepse për këtë përmenden hadithe që transmetohen prej të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem ku thuhet:

“Lironi robërit, përgjigjuni atij që ju thërret dhe vizitoni të sëmurët.” (Transmeton Buhariu prej Ebu Musa el-Esh'ariut.)

“Kur të thirreni në gostinë e martesës, përgjigjuni asaj, ai që nuk përgjigjet, ai ka bërë gjuhah ndaj Allahut dhe ndaj Pejgamberit të Tij.” (Transmeton Buhariu, IX/198, Muslimi, IV/152, Ahmedi nr. 6337, Bejhekiu, VII/262 prej Ibënu Omerit.)

• **Duhet t'i përgjigjemi thirrjes, madje edhe nëse jemi agjërueshëm:**

Njeriu duhet t'i përgjigjet thirrjes, edhe nëse është duke agjëruar, sepse i Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem thotë:

“Kur ndonjëri prej jush thirret në udhqim, le të përgjigjet, nëse nuk është duke agjëruar le të hajë, ndërsa nëse është duke agjëruar, le të vijë, që do të thotë, le t'i përgjigjet thirrjes.” (Transmeton Muslimi, IV/153)

• Prishja e agjërimit me insistim të atij që ka ftuar në gosti:

Njeriu mund të bëjë iftar nëse është duke agjëruar në mënyrë vullnetare, posaçërisht kur këtë e insiston ai që e ka ftuar në gosti.

I Dërguari i Allahut sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem thotë: **“Kur ndonjëri prej jush thirret në gosti, le të përgjigjet, nëse do të hajë, le të hajë, ndërsa nëse nëse nuk do, mund të mos hajë.”** (Transmetojnë Muslimi, Ahmedi, III/392.)

I Dërguari i Allahut sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem thotë: **“Ai që agjëron vullnetarisht, ai vetë e vendosë, nëse do ai mund ta vazhdojë agjërimin, ndërsa nëse do mund ta prishë.”** (Transmeton Nesaiu në veprën El-Kubra, II/64, Hakimi, I/439, Bejhekiu, IV/276 prej Simak b. Harbit, ai prej Ebu Salihut, ai prej Ummu Hane si merfu'.)

Transmetohet prej Aishes radijAllahu 'anha se kishte thënë: **“Një ditë te unë erdhi i Dërguari i Allahut sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem dhe më pyeti: “A ka diçka për të ngrënë?”** Unë iu përgjigja: **“Nuk ka.”** Kaloi një pjesë e ditës, ndërsa mua më sollën një ushqim të quajtur hajsa - ushqim prej hurmave, djathit dhe tëlyenit. Një pjesë të ushqimit ia lashë të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, kurse ai e donte shumë këtë udhqim. I thash: **“O i Dërguari i Allahut, më erdhi si dhuratë ky ushqim - hajsi dhe të lash pak prej tij.”** Ai tha: **“Ma sjell, me të vërtetë kam gdhirë si agjërues.”** Ai hëngri dhe tha: **“Shembulli i agjërimit vullnetar është sikurse shembulli i njeriut i cili prej pasurisë së tij ka ndarë një pjesë për sadaka, nëse do, mund ta ofrojë, ndërsa nëse do, mund ta kthejë.”** (E përmend Nesaiu me zinxhir sahih.)

ATË QË DUHET TA DIJË SECILI BASHKËSHORTË.

Ne kemi shumë nevojë dhe është me rëndësi kruciale që të paraqiten dhe të studiohen këto çështje që kanë të bëjnë me marrëdhëniet martesore dhe intime mes bashkëshortëve.

Kjo nevojë posaçërisht sot ka ardhur në shprehje për shkak të hovit të madh të shumë traditave të këqija dhe të aktiviteteve amorale, programeve dhe propagandave.

• A i lejohet burrit që të shikojë në organin gjenital të gruas së tij dhe gruas të shikojë në organin gjenital të burrit të saj?

Disa dijetarë transmetojnë hadithe joautentike që flasin për ndalimin e shikimit të bashkëshortëve në njëri-tjetrin. Qëndrimi i dijetarëve ëshë se burrit dhe gruas u lejohet në çdo situatë që të shikojnë në organin gjenital të bashkëshortit të vet.

“Argument për këtë janë fjalët e Aishes e cila kishte treguar se bashkë me të Dërguarin e Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem ishte larë prej të njëjtës enë.” (Ahmedi, 3/383

Imam Maliku ishte pyetur se a mundet njeriu të ketë marrëdhënie me gruan, nëse mes tyre nuk ka rroba që i ndajnë dhe ai këtë e kishte lejuar. Kur i kishin thënë se disa këtë e konsiderojnë të ndaluar, ai kishte thënë: **“Largohu prej asaj që e thonë ata. I Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem është larë bashkë me Aishen, kurse që të dy ishin të zhveshur.”**

• A është sunnet që bashkëshorti të lozë me gruan dhe ta ledhatojë atë para marrëdhënieve seksuale?

Mjekja Ikram Tal’at thotë: **“Marrëdhëniet seksuale në mes bashkëshortëve i përfshin të gjitha llojet e prekjeve ledhatuse në mes bashkëshortëve.**

Marrëdhënia e plotë seksuale i përfshin tri etapa:

- **Paraloja dhe argëtimi të cilat psikologjikisht e përgatisin gruan për marrëdhënie seksuale;**

- **Ndezja e dashurisë së ndërsjellë dhe emocionet që arrihen me prekje dhe me puthje;**

- **Vetë akti i marrëdhënieve seksuale që fillon me hyrjen e organit gjenital të mashkullit në organin gjenital të gruas dhe zgjatë deri në përfundim.”**

Këtu duhet të përmendim se paraloja është sunnet, sepse shejhul-islam Ibën Kajjim thotë: **“Ajo që i paraprin marrëdhënieve seksuale është lozja me gruan, puthjet dhe thithja e gjuhës, sepse i Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem ka lozur me bashkëshortet e tij dhe i ka puthur ato.”**

Në bazë të gjithë kësaj, duhet të tregojmë se paraloja është fara e dashurisë, qetësimi i zemrës, rehatia e shpirtit, aktiviteti i trupit dhe lind besimin e njërit bashkëshort ndaj tjetrit.

• **Bashkëshorti a mund të lozë me gruan gjatë agjërimit?**

“Në mënyrë autektike është transmetuar prej të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem se ai gjatë agjërimit i kishte puthur gratë e tij, i kishte përkëdhelur dhe i kishte përqaftuar, por pa prekjen e organit gjenital. Argument për këtë janë fjalët e Aishes radijAllahu ‘anha e cila kishte treguar se si i Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem i kishte puthur gratë e tij derisa kishte agjëruar.” (Buhariu, 113/1.)

• **A lejohet thithja e gjuhës dhe buzëve të gruas?**

“Lejohet që bashkëshortëve t'ia thithim gjuhën, buzët dhe të thithet pështyma e gruas, sepse transmetohet se Ebu Hurejre ishte pyetur lidhur me këtë dhe ai kishte thënë se këtë e bën edhe kur është duke agjëruar.” (Hadithi është në Musnif dhe është autentik.)

• **A është e lejuar që burri dhe gruaja të bisedojnë e të flasin gjatë marrëdhënieve seksuale?**

Autoriteti i shquar Siddik Hasan Han në librin Revdatun-nedije të cilin e ka komentuar imam Albani, thotë se nuk ka kurrfarë problemi e pengese që bashkëshortët gjatë marrëdhënjeve seksuale të bisedojnë dhe biseda është e lejuar dhe nuk është e ndaluar. **“Koha e marrëdhënieve seksuale është koha e kënaqësisë dhe në ato momente pritet prej bashkëshortëve që ta shprehin zjarrin e dashurisë dhe me fjalët e tyre ta përforcojnë dëshirën, mallin dhe epshet e njërit ndaj tjetrit dhe një bisedë e tillë është e lejuar.”**

• **A lejohen psherëtimat dhe zëri i lartë gjatë marrëdhënieve seksuale?**

Po, lejohen psherëtimat, ngritja e zërave dhe dihatja gjatë marrëdhënieve seksuale, nëse kjo e nxitë epshin seksual te burri ose te gruaja dhe nuk shkakton reagime negative te ndonjëri prej këtyre dyve. Kjo është e ndaluar nëse këtë e sheh ose e dëgjon fëmija.

• **Çfarë u lejohet burrit te gruaja me rastin e marrëdhënieve seksuale?**

Burrit i lejohet që të kënaqet me gruan kur të dëshirojë, si të dëshirojë dhe kudo që të dëshirojë, përveç në një periudhë dhe në një vend.

Koha e ndaluar është koha e menstruacioneve dhe pastrimit pas lindjes dhe burrit atëherë nuk i lejohet që në këtë periudhë të ketë marrëdhënie me gruan.

Vendi që është i ndaluar është vrima anale dhe kjo sipas qëndrimit të dijetarëve është haram. Të këtij qëndrimi janë Abdullah b. Amr b. Asi, Ebu Hurejre, Abdullah b. Abbasi, Ibën Mes'udi.

• A i lejohet burrit që të kënaqet me pjesën e jashtme të prapanicës, pa marrëdhënie seksuale në vrimën anale?

Imam Shafiu ka thënë: **“Nuk është problematike që burri të kënaqet me prapanicën e gruas së tij pa pasur marrëdhënie seksuale në vrimën anale.”**

“Qëndrim të njëjtë ka edhe El-Makdisi i cili thotë se burrit i lejohet që të kënaqet në mes dy pjesëve të prapanicës, por pa marrëdhënie seksuale në vrimën anale.” (Kitabul-kafi, 124/3)

Ibën Xheuzi e konsideron të ndaluar ejakulimin ndërmejt dy pjesëve të prapanicës, sepse kjo mund të shkaktojë marrëdhënie seksuale në vrimën anale dhe si preventivë e konsideron të ndaluar.

• Cila është dispozita e prekjes dhe puthjes së organit gjenital të bashkëshortëve?

Kurtubiu në Tefsirin e tij thotë: **“Njerzitë kanë mendime të ndryshme se a është e lejuar që burri të shikojë në organin gjenital të gruas së tij dhe njëri prej qëndrimeve është se kjo është e lejuar. Ky është qëndrimi i numrit më të madh të dijetarëve të cilët thonë se burrit i lejohet që me gjuhë ta prekë organin gjenital të gruas së tij. Kadi Ebu Ja'la, dijetar hanbelij thotë se burrit i lejohet puthja, thithja dhe me gjuhë ta prekë organin gjenital të gruas, por gjithashtu kjo i lejohet dhe gruas me qëllim që të arrihet harmonia mes tyre. Në këtë mënyrë do të përgaditen që sa më me epush duke u kënaqur të përfundojnë marrëdhënien seksuale. Burrit dhe gruas u lejohet që me buzë ta prekin e ta thithin çdo pjesë të bashkëshortit. Të gjitha këto i ka lejuar Allahu i Lartësuar, sikurse burrit ashtu edhe gruas në të njëjtën kohë, sepse gruaja është partnerja e burrit dhe asaj i lejohet ajo që i lejohet burrit. Edhe burrit, edhe gruas u lejohet që ta prekin organin gjenital të bashkëshortit të vet dhe kjo është një lloj kënaqësie dhe nuk ekzistojnë argumente sheriatike për ndalimin e kësaj.”**

(Doktor Jusuf el-Kardavi lidhur me këtë çështje ka thënë: **“Kur është në pyetje puthja, dijetarët atë e lejojnë. Nuk ka kurrfarë pengese që gruaja ta**

puth organin gjenital të burrit dhe burri ta puth organin gjenital të gruas së vet. Nëse këtu mendohet në ejakulim në gojën e bashkëshortes, atëherë ndoshta këtu mund të ekzistojë qortimi, por nuk mund të them se kjo është e ndaluar, sepse nuk ekziston argument kategorik që tregon në ndalesën.” Disa dijetarë e kushtëzojnë lejimin e seksit oral me atë që kjo mos t'i dëmtojë bashkëshortët dhe që papastërtia mos të depërtojë në organizmin e ndonjërit prej tyre **(vër. Recens.)** Dmth edhe pse çdo gjë është e lejuar, nuk është e përjashtueshme që të aplikohet)

KUR ËSHTË E OBLIGUAR LARJA E BASHKËSHORTËVE?

Larja është e obligueshme në këto situata:

- Me rastin e derdhjes së spermës dhe sekrecionit të grave, pa marrë parasysh se a është arritur kjo me anë të marrëdhënieve seksuale në ëndërr, në lojë me bashkëshortin. Ummu Seleme kishte shkuar te i Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem dhe e kishte pyetur: **“O i Dërguari i Allahut. Allahu nuk turpërohet prej të vërtetës. Gruaja a është e obliguar që të lahet nëse ejakulon në gjumë?”** Pejgamberi sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem u përgjigj: **“Po, kur vërenë gjurmët e lëngut.”** (Buhariu, 61/1)

- Nëse vjen deri te kontakti i organeve gjenitale, edhe nëse nuk vjen deri te ejakulimi. Disa njerëz pa dituri konsiderojnë se larja është e obliguar vetëm nëse vjen deri te dalja e spermës. Ky është mendim i gabuar dhe larja bëhet obligim në atë moment kur vjen te kontakti i majës së organit gjenital të burrit dhe vaginës së gruas. Pra, atë moment kur në vaginë hyn maja e organit gjenital të burrit, obligohet larja;

- Nëse vjen deri te seksi oral, pa ardhur te ejakulimi, nuk është obligim larja. Larja obligohet vetëm në situatën kur vjen te kontakti i organeve gjenitale ose në raste të tjera, kur vjen deri te ejakulimi.

ÇKA ËSHTË MIRË GRUAJA TË BËJË PARA MARRËDHËNIEVE?

- Të përpiqet që t'i plotësojë dëshirat dhe kërkesat e burrit,

- Që të zbukurohet dhe të parfumohet, me qëllim që burri te ajo mos të vërej asgjë që urren ose që nuk e do;

- Gruaja duhet të marrë pjesë në mënyrë aktive në marrëdhënien seksuale dhe duhet t'i përgjigjet burrit dhe ajo nuk duhet që të qëndrojë sikur një mur i palëvizshëm;

- Gruaja duhet të përgadisë një leckë me të cilën pas marrëdhënieve do ta mbledh lëngun prej burrit të saj dhe prej vetes, sepse transmetohet prej Aishes, nënës së besimtarëve, se kishte thënë: **“Gruas së mençur i ka hije që para marrëdhënieve ta përgatitë leckën.”**

CILAT JANË POZICIONET MË TË MIRA NË MARRËDHËNIET SEKSUALE?

Pozita më e mirë është që gruaja pas paralojës dhe përkdheljeve, të shtrihet në shpinë, ndërsa burri shtrihet mbi të.

Imam Sujuti thotë: **“Ekzistojnë shumë pozita në marrëdhëniet seksuale, ndërsa pozita më e mirë është që gruaja të shtrihet me shpinë në shtrat, me qëllim që njeriu të varet mbi të dhe pozitën gjysëm të shtrirë, ajo të jetë me gjunjë të ngritur dhe me kokë të balancuar, jo shumë të ngritur, sepse kështu ofron kënaqësi më të madhe.”**

Gruaja nëse dëshiron të mbetet shtatzënë, me këtë rast, gjatë derdhjes së spermës ajo duhet t'i ngritë lartë gjunjët dhe ta çojë mbrapa kokën. Pas kryerjes marrëdhënieve, gruaja duhet të qëndrojë në këtë pozitë për një kohë, me qëllim që sperma të depërtojë në thellësinë e mitrës. Nëse gruaja e trashë dëshiron të mbetet shtatzënë, atëherë është më mirë ta përdorë pozitën, ashtu që ajo të mbetet në gjunjë, sepse kështu më mirë hapet dhe sperma depërton më thëllë.

Në fund, edhe burri edhe gruaja kanë te drejtë të plotë që ta zgjedhin atë pozitë e cila më së miri u përshtatet të dyve. Gjithë atë që e thonë dijetarët lidhur me këto pozita, është fryt i përfundimeve të tyre. Burri dhe gruaja kanë lirinë e plotë për të zgjedhur pozitën që më së miri u përshtatet; misionare, në gjunjë, në anën e djathtë ose të majtë...

• A ekzistojnë pozita të tjera?

Kuptohet se po dhe ato janë të lejuara, kur burri i afrohet gruas prej anësh, kur burri i afrohet gruas prej nga shpina. Me rastin e natës së parë të martesës, gruaja më së miri është të shtrihet në shpinë, që deri në gjoks t'i afrojë gjunjët me qëllim që të hapen buzët e vogla dhe që burri ta depërtojë

himenin. Në situatën kur gruaja është shtatzënë, më së miri është ajo të jetë mbi burrin e saj, kurse burri të shtrihet në shpinë, sepse në të kundërtën, burri mundet, posaçërisht në muajt e parë të shtatzënisë, të ndikojë dëmshëm në frytin. Në të gjitha situatat tjera, bashkëshortët mund ta përdorin atë pozitë të cilën më së shumti e duan; qoftë në shtrat ose në dysheme, në këmbë ose ulur, që gruaja të ulet në karrige, kurse burri përmbi, që burri të ulet në karrige, ndërsa gruaja të qëndrojë përmbi, atë pozitë të cilën bashkëshortet e duan, të njëjtën duhet ta praktikojnë.

• **Orgazma më shpejt vjen te burri apo te gruaja?**

Dijetarët flasin se burri e ka për obligim që ta zgjasë paralojën me gruan e tij në shtrat, që sa më shumë ta përkëdhelë, që t'i thithë buzët e saj, që të lozë me gjinj të saj, që të përkëdhelë prapancën e saj dhe pjesën e poshtme të shpindës, duke i nxitur kështu zonat erogjene derisa gruaja mos ta ndryshojë fytyrën. Atëherë burri mundet ngadalë dhe gradualisht ta fusë organin e tij gjenital në organin gjenital të gruas dhe me tempo të shpejtë ta çojë deri te orgazmi, për shkak se gruaja shumë ngadalë e përjeton kulminacionin sesa burri dhe burri duhet ta ketë parasysh.

• **Si ta vendosim balancën seksuale mes burrit e gruas?**

Për fat të keq, sot ka shumë burra të cilët vetë kënaqen në jetën seksuale, ndërsa nuk ua lejojnë grave të tyre që ta përjetojnë të njëjtën. Kjo dukuri vetvetiu është shkak i ikjes së gruas prej marrëdhënieve seksuale. Vetë fakti se gruaja më ngadalë vjen deri te orgazmi në marrëdhëniet seksuale, kjo e bën burrin faktor kryesor në këto marrëdhënie dhe të obligueshëm që të përpiqet me qëllim që sa më vonë ta prolongojë orgazmën e tij dhe në përputhje me gruan e tij. Hulumtuesit shpesh theksojnë se afërsia e arritjes së orgazmës te gruaja dhe burri është shenjë e suksesit të jetës seksuale.

• **Cila është lidhja në mes gjinjve dhe organit gjenital?**

Lidhja në mes këtyre dyjave është shumë e fortë dhe e pandashme deri në atë masë, sa që e gjithë ajo që shkakton nxitje seksuale te njëra, ajo shkakton nxitje seksuale edhe tjetra. Gjithë ajo që shkakton nxitje seksuale në gjoks, ajo shkakton nxitje seksuale në organet gjenitale dhe në sistemin nervor të gruas.

• **A ndikon gjatësia e organit gjenital të burrit në kënaqjen seksuale të gruas?**

Është e vërtetuar se gjatësia e organit gjenital të mashkullit nuk ka rëndësi në kënaqjen seksuale të gruas. Mund të ndodhë që gruaja të përjetojë orgazmën edhe pa përdorimin e organit gjenital të mashkullit, gjatë kohës së paralojës para vetë aktit seksual. Gjatësia mesatare e organit gjenital të mashkullit sillet prej 13 deri në 18 cm, ndërsa thellësi të këtillë ka edhe organi gjenital i femrës. Këtu duhet të përmendet edhe ajo se organi gjenital i femrës nuk merr pjesë i tëri në nxitjen seksuale dhe në arritjen e orgazmat, por në këtë rol ka vetëm hyrja në vagjinë.

• **Si të ruhet dashuria e zjarrtë në martesë?**

- 01.** Dhuroi gruas lule e cila do ta tregojë tërë madhështinë e dashurisë;
- 02.** Gëzoje atë, duke i dërguar asaj nganjëherë kafjallin në shtrat;
- 03.** Mos i harro ditët e rëndësishme nga jeta jote;
- 04.** Thirre shpesh në telefon nga puna dhe tregoi se sa mendon për të dhe se sa i mungon;
- 05.** Shko me të në piknin gjatë vikendit;
- 06.** Shetitu me të në kohën e lindjes dhe perëndimit të diellit;
- 07.** Foli asaj për ëndërrat dhe idetë tua, edhe ajo le të marrë pjesë në planifikime;
- 08.** Përpiqu më shpesh ta gëzosh me ndonjë parfum ose me ndonjë dhuratë të ngjashme;
- 09.** Shpesh thuaji se krenohesh me të dhe se mahnitesh;
- 10.** Puthë kur të nisesh prej banesës dhe kur të kthehesh.

ZONAT EROGJENE NË TRUPIN E BURRIT DHE GRUAS.

Në trupin e burrit e gruas gjenden shumë zona erogjene:

- **Goja, buzët dhe gjuha:** lidhja në mes organeve gjenitale dhe gojës, buzëve dhe gjuhës është shumë e fortë. Për këtë shkak, puthja qysh prej kohërave të lashta ka qenë mënyrë për shprehjen e dashurisë dhe ajo është njëra prej llojit kryesor të paralojës së burrit dhe femrës;

- **Veshët:** prekja e veshëve me buzë ose me gjuhë e shton kënaqësinë dhe ndez epshet. Ngacmimi i veshit mund të bëhet me prekjen e laprave me gjuhë ose brendinë e veshit ose duke pëshpëritur fjalë romantike të cilat i nxisin epshet dhe dëshirën. Po ashtu, ky efekt mund të arrihet me frymëmarrje të shtuar dhe me psherëtima në vesh;

- **Gjinjtë:** erogjeniteti i ktyre pjesëve të trupit është e dukshme dhe përfshin vendin e dytë në mesin e organeve, menjëherë pas organeve gjenitale. Madje, vetëm shikimi i gjinjve të gruas te burri shkakton ndikim të fortë dhe sikurse magji ndikojnë në mendimet e tij dhe në fantazinë seksuale. Edhe nëse njeriu nuk ka dëshirë të shprehur seksuale, ajo dëshirë nxitet me vetë shikimin e gjinjve të gruas.

Secili kontakt me gjoksin e gruas, qoftë me duar ose me buzë, duhet të jetë krejtësisht i butë, sepse ngacmimi i tyre është nxitës i epsheve edhe te burri, edhe te gruaja. Duhet të kemi parasysh se zona më e fuqishme erogjene te gratë në gjoks mund të jetë ne mes, por edhe nuk do të thotë se është, kjo dallon prej gruas në grua. Burri duhet ta hulumtojë trupin e gruas së tij;

- **Kofshët dhe gjunjët:** ashtu hyjnë në zonat erogjene te gruaja dhe ngacmimi i tyre ndikon fuqishëm në aktivitetin seksual.

Të gjitha këto zona te burri dhe gruaja nxiten duke i përkdhelur dhe duke i prekur, duke dërguar kështu të fuqishme deri te sistemi nervor dhe në tru, ku kjo ndjenjë mund të ndalet vetëm me kontaktin e organeve gjenitale.

DISA PROBLEME NË JETËN SEKSUALE DHE SHËRIMI I TYRE.

• Sihri a ndikon në aftësinë seksuale?

Sihri është realitet të cilin mund ta mohojë vetëm mendjemadhi dhe mund të ndikoj në aftësinë seksuale. Secili njeri që është i goditur me këtë lloj të sihrit, duhet të përpiqet që të çlirohet prej tij, duke kërkuar ndihmë dhe mbrojtje prej Allahut të Lartësuar, të bëjë ibadete dhe të lutet sa më shumë. Në shërim përdoren metodat tradicionale sheriatike të shërimit të sihrit.

• A ndikon masturbimi në marrëdhëniet seksuale?

Dijetarët myslimanë kanë mendime të ndryshme lidhur me dispozitën e masturbimit. Shafijtë dhe ata që pajtohen me ta, masturbimin e konsiderojnë

të ndaluar, duke u mbështetur në fjalët e Allahut: **...“të cilët e ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme), përveçse me gratë e tyre ose me skllavet që kanë në zotërim...”** (El-Mu'minun, 5-6)

Të dytët, hanbelijtë konsiderojnë se burri në momentin e sulmit të epsheve dhe të dominimit të tyre mbi njeriun, me qëllim që të mos bjerë në mëkat, ai e ka lejuar të masturbojë. Mjekët konsiderojnë se masturbimi ka pasoja të dëmshme, prej të cilave i përmendin:

- Nuk arrihet kënaqësia e plotë seksuale;
- Është një zakon i lig dhe tërheq pas vetes rrezik të madh psikologjik;
- Praktikimi i shpeshtë të meshkujt shkakton paraqitjen e plagëve nëpër organet gjentiale dhe dhembje në testise. Te gratë shkakton gjakderdhje të madhe në rastin e menstruacioneve dhe ndikon në sistemin e gjakut të gruas. Po ashtu, mund të shkaktojë dhembje të shtuar gjatë menstruacionit;
- Praktikimi i këtij aktiviteti te djemtë dhe vajzat shkakton formimin e qëndrimit të caktuar rreth kënaqësisë seksuale dhe ka efekte të fuqishme psikologjike, kurse shpesh shkakton edhe pakënaqësi me jetën seksuale në martesë;
- Te virgjëresha, masturbimi i shpeshtë mund të shkaktojë mosparaqitjen e gjakut në natën e parë të martesës dhe kështu të shkaktojë probleme në martesë.

• Puna intelektuale a ndikon në dobësimin e dëshirës seksuale?

Po, puna intelektuale ndikon në dobësimin e dëshirës seksuale, sepse njeriu në gjendje të këtyllë i nënshtrohet shqetsimit, ngarkesës nervore, por edhe histerisë. Për këtë shkak, një punë e këtyllë duhet të jetë e kufizuar në kohë dhe në hapsirë, sepse njeriu ka obligime ndaj trupit të vet.

• A ndikon diabeti në aftësinë seksuale?

Po, diabeti ndikon në aftësinë seksuale dhe problemet e para që paraqiten këtu janë ereksioni i dobët, ndërsa për shkak të dobësimin të qarkullimit periferik dhe për shkak të dobësimin të sistemit nervorë periferik.

Shërimi i këtij problemi arrihet me rregullimin e mirë të nivelit të sheqerit në gjak, duke iu larguar ushqimit me indeks të lartë glikemik, me përdorimin e terapisë dhe me aktivitete sportive, posaçërisht me shëtitje.

• **Ejakulimi i burrit para gruas a është shenjë e dobësisë seksuale?**

Ky është mendim i gabuar të cilën e kanë disa njerëz. Një qënim i këtillë zgjon pesimizmin dhe futë shqetësim te shumë njerëz.

• **Si të ndalohet ejakulimi i parakohshëm?**

Burri në shumë mënyra mund të ndikojë në prolongimin e ejakulimit:

- Me futjen e organit gjenital në organin gjenital të gruas ngadalë, butë dhe me kujdes;
- Menjëherë pas futjes së organit gjenital, duhet t'i ndalojë lëvizjet;
- Duhet të mendojë për gjëra indirekte gjatë marrëdhënieve seksuale;
- Lëvizjet duhet t'i bëjë gradualisht.

• **Afrodiziakët që forcojnë dëshirën seksuale:**

Nuk mund të kontestohet lidhja e forte në mes ushqimit të cilin njeriu e konsumon dhe dëshirës e aftësisë seksuale. Në këtë kapitull do të flasim diçka më shumë lidhur me këtë lidhje dhe rreth asaj se cilat udhëime ndikojnë pozitivisht në forcimin e dëshirës dhe aftësisë seksuale.

• **A ekziston lidhja në mes hurmave të thata e të buta dhe seksit?**

Allahu i Lartësuar thotë:

“Dhembjet e lindjes e detyruan atë që të shkonte te trungu I një hurme. Ajo tha: “Ah, sikur të kisha vdekur para kësaj (ngjarjeje) dhe të isha harruar krejt!” Një zë e thirri nga poshtë: “Mos u pikëll, se Zoti yt të ka bërë një burim uji poshtë teje! Shkunde trungun e palmës, që të bien mbi ty hurma të freskëta! Ha, pi dhe qetësohu.” (Merjem, 23-26)

Në anën tjetër, i Dërguari I Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem thotë:

“Banorët e shtëpisë në të cilën nuk ka hurma, ata janë të uritur.”

(Buhariu)

Ibën Kajimi thotë se hurmat, të thata e të njoma, janë shumë të dobishme dhe të ushqyeshme për trupin dhe e forcojnë fuqinë seksuale. Njeriu kur vazhdon

në konsumimin e tyre, ato e forcojnë shpretkën. Posaçërisht janë të dobishme për forcimin e aftësisë seksuale kur janë të përziara me kokrra të pishës.

Hurmat janë të pasura me vitaminë A, B2 dhe B6 dhe të gjitha këto vitamina ndikojnë fuqishëm në metabolizmin e qelizave. Vitamina A është posaçërisht e rëndësishme në përtëritjen e qelizave seksuale te burri dhe te gruaja.

Hurma është e pasur dhe me aminoacide që ndikojnë pozitivisht në punën e drejtë të kanaleve të sperms dhe të prostatës.

• **A ekziston lidhja në mes mjaltit dhe aftësisë seksuale?**

Allahu i Lartësuar thotë: **“Nga barku i tyre del lëng ngjyrash të ndryshme, në të cilin ka ilaç e shërim për njerëzit.”** (En-Nahl, 69)

Mjeku antik Hipokrati ka thënë: **“Kush dëshiron që edhe pas të dyzetave ta ruaj rininë, atëherë në udhëqim le ta fuse mjaltin.”**

Studimet e shumta tregojnë për dobinë e madhe të mjaltit në forcimin e aftësisë seksuale dhe në përgjithësi në shëndetin e përgjithshëm në gjithë këtë ka edhe qumshti i bletës i cili e forcon organizmin dhe aftësitë seksuale.

• **A ekziston lidhja në mes mishit të peshkut dhe aftësisë seksuale?**

Peshku dhe kafshët tjera të detit përmbajnë sasi të madhe të jodit që është element shumë i rëndësishëm në nxitjen e dëshirës për marrdhënie seksuale edhe gjatë vetë marrëdhënieve. Po ashtu përmbajnë edhe fosfor që është shumë i rëndësishëm në transmetimin e sinjaleve elektronike prej sistemit periferik në atë qendror gjatë marrëdhënieve seksuale.

Po ashtu përmbajnë edhe sasi të madhe të proteinave që kanë vlerë të madhe energjetike edhe aminoacidet që hyjnë në përbërjen e sistemit të organeve për riprodhim. Për këtë shkak, duhet të hamë sa më shumë mish peshku, sepse marrëdhënia seksuale kërkon trup të forte e të shëndetshëm, ndërsa që trupi të jetë i këtyllë, duhet të ushqehet me ushqim të shëndetshëm.

• **A ekziston lidhja në mes disa llojeve të perimeve dhe aftësisë seksuale?**

Lakra dhe sallata e gjelbër hyjnë në mesin e llojit që bluhën më lehtë, por në të njëjtën kohë të pasura dhe me vitamina dhe me ndikim të fuqishëm si afrodisiakë.

Le të jetë praktikë e jona që në ditë të hamë një pjatë të sallatës së gjelbër, me lëngë limoni, sepse kjo ndikon në mënyrën të mire jo vetëm në fuqinë seksuale, por edhe në tërë organizmin. Sallata e gjelbër dhe lakra qëmoti janë të njohura si afrodisiakë të fuqishëm.

Po ashtu, afrodisiak i forte janë edhe të gjitha llojet e hudhrave, mirëpo kur është në pyetje hudhra, atëherë ajo duhet të përdoret në pajtim të dyanshëm të bashkëshortëve për shkak të ërës jo të mirë.

• **Cila është lidhja në mes disa llojeve të pemëve dhe aftësisë seksuale?**

Për shkak se aftësia seksuale dukshëm mbështetet në ekuilibrinë psikik dhe në rehatinë nervore, atëherë roli i pemëve në këtë është e pashmangshme. Duhet të theksojmë se këtu të dobishme janë pjeshka, portokalli, dardha, rrushi. Këto lloje të frutave janë afrodisiakë natyrorë që e përmirsojnë gjakun dhe lidhjen e sistemit periferik me atë qendror nervor.

• **Cila është lidhja në mes disa pijeve dhe aftësisë seksuale?**

Orkideja (në popull e njohur si salep): rrënjët e orkides janë të njohura si ushqyese dhe lëvizëse të fuqishme të epsheve. Kjo pije përgaditet ashtu që pluhuri i rrënjeve të orkidesë zhytet në pak ujë të ftohtë, pastaj zhytet në sasinë më të madhe të ujit të ngrohtë dhe zihet mire dhe lihet derisa të bashkohet. Pas kësaj merret me lugë në intervale të shpejta.

Gjëmbaçi: (gjëmbaçi i bardhë, artiçoku i egër) është bimë e njohur që përdoret si afrodisiak i fuqishëm, posaçërisht i zier me mjaltë. Pija me këtë bimë përgaditet ashtu që farat e kësaj bime pastrohen dhe në një gotë me ujë të ftohtë hidhen dy lugë. Kështu qëndron rreth tri orë, pastaj ngrohet në zjarr dhe vlon një minutë. Ky çaj pihet dy-tre filxhanë në ditë, të ëmbëlsuar me mjaltë.

Kanellë: Kanella është melmesë e njohur aromatike, pluhuri i së cilës përdoret për përmirsimin e punës së sistemit të gjakut dhe për forcimin e aftësisë seksuale.

Tri lugë kanellë vendosen në një gotë ujë dhe kjo zihet në zjarr derisa uji most a ndryshojë ngjyrën në të kuqe dhe kështu pihet.

Karafili: karafili është afrodisiak shumë i forte dhe kthen rininë, posaçërisht kur përdoret me jogurt dhe me qumësht. Pija prej karafilit përgaditet ashtu që një lugë e vogël e kokrrave të karafilit treten në një gotë ujë dhe lihet që të vlojë në zjarr, kur të ftohet, pihet.

Xhenxhefil: xhenxhefil është shumë I dobishëm për tërë trupin, neutralizon gazrat, është i këndshëm dhe i butë për stomakun, e përmirëson tretjen, ndihmon në nxjerrjen e ujit prej organizmi dhe e përforcon aftësinë seksuale.

Xhenxhefil përdoret me mjaltë në formë të xhemit, hahet i ftohtë pas përzierjes, por mund pak të ngrohet që të lëshohet. Si pije përdoret ashtu që gjysëm lugë xhënkhëfil në pluhur përzihet me një lugë mjaltë. Kjo përzihet mirë, pastaj kësaj përzierje i shtohet një gotë ujë të ngrohtë dhe pihet sipas nevojës. Allahu i Lartësuar duke folur për xhenxhefilin thotë:

“Aty do të pinë gota me pije të përzier me xhenxhefil.” (El-Insan, 17)

Anason: është afrodisiak i mirë, madje edhe Ibën Sina e ka përmendur për këto karakteristika. Mjekësia moderne vërteton se kjo bimë është e dobishme te grate në përforcimin e vezoreve, gjatë lindjes dhe lehtëson problemet menstruale. Përgaditet ashtu që një lugë e frytit të bluar të kësaj bime zihet në ujë të vluar dhe kjo lihet që të qëndrojë, kur të ftohet pihet nga një ose nga një gotë e gjysmë të këtij çaji. Nuk rekomandohet që të pihet më shumë se kjo dozë.

Qimnon: bimë e njohur që në mjekësinë tradicionale përmendet si nxitës i epsheve. Kjo pije përgaditet ashtu që një lugë e frutave të bluar vendoset në një gotë të ujit të vluar dhe kjo pihet gjatë një dite.

• **Cila është lidhja mes barishteve dhe aftësisë seksuale?**

Safrani: emër me prejardhje semite që do të thotë i verdhë, sepse kjo bimë lëshon ngjyrë të verdhë. Lulet e kësaj bime mbledhen pas lulëzimit dhe thahen në vende të posaçme. Kjo bimë qysh prej kohërave të lashta është e njohur si afrodisiak.

Maraq: ose maraq i egër është bimë që njihet që nga lashtësia dhe qysh prej atëherë është e njohur si bimë mëlmese. U shtohet sallatave si mëlmesë dhe e forcon fuqinë seksuale.

F U N D.